



SHKODRA

LEZHA

SKENARËT E ZHVILLIMIT NËNRAJONAL NË QARKUN E LEZHËS

*Për Zbatimin dhe Monitorimin e Konceptit Strategjik të Zhvillimit Rajonal
Këshilli i Qarkut Lezhë - 2015*

ISBN: 978-9928-175-67-0



9 789928 175670



with funding from

Austrian
Development Cooperation



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Skenarët e Zhvillimit Nënrajonat në Qarkun Lezhë



Programi i Zhvillimit Rajonal në Shqipërinë Veriore

Financuar nga: Austrian Development Cooperation, Swiss Agency for Development and Cooperation

Zbatuar nga: Helvetas Swiss Intercooperation, Co-Plan, ÖAR Regionalberatung GmbH.

Autorët:

Këshilli i Qarkut Lezhë: Linda Maci, Manushaqe Hilej, Mark Ruçi, Arviola Begaj, Artan Palushi, Viktor Gjokolaj, Vitore Isufi.

Agjencia e Zhvillimit Rajonal Lezhë (LERDA): Artan Gjoka, Hekuran Koka, Ajsel Reka.

Mbështetur nga:

RDP/ Co-Plan: Olaf Haub, Dritan Shutina, Anila Gjika, Altin Mihali, Besmira Dyca.

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive.....	5
Fjala Përshëndetëse	6
Shkurtime	7
I. Panorama e Përgjithshme.....	9
a. Përshkrim i shkurtër i Qarkut të Lezhës.....	9
b. Roli i Qarkut, funksionet dhe nevoja për qeverisje rajonale	12
c. Situata aktuale e planifikimit strategjik në Qark	14
d. Qëllimi i dokumentit “Skenarët e zhvillimit nënrajonale në Qarkun Lezhë” dhe metodologjia e hartimit të tij	20
II. Analiza Nënrajonale	21
a. Koncepti i “nënrajonit” dhe rëndësia e tij në planifikimin rajonal	21
b. Identifikimi i nënrajoneve dhe formulimi i skenareve të zhvillimit nënrajonale	23
c. Përgatitja e Projekteve Pilote dhe e Planit të Veprimit	36
• Metodologjia e përdorur për përzgjedhjen e projekt-propozimeve	37
• Matrica përfundimtare e projekt propozimeve.....	39
• Modeli fishës së projekteve	47
• Plani Veprimit dhe mundësitë e financimit	48
III. Monitorimi.....	54
a. Metodologjia e monitorimit të zbatimit të Konceptit të Zhvillimit të Qarkut Lezhë	54
b. Indikatorët e monitorimit për çdo masë	57
Referenca.....	69
Aneks 1 Harta të shpërndarjes së projekt propozimeve	70
Aneks 2 Fishet shembuj për projekt propozimet	74
Aneks 3 Plotësuese.....	82

Përmbledhje Ekzekutive

Dokumenti “Skenarët e zhvillimit nënrajonat në Qarkun Lezhë” është hartuar në kuadër të zbatimit të Programit të Zhvillimit Rajonal në Shqipërinë Veriore (Regional Development Program Northern Albania – RDP); program i financuar nga Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) dhe Austrian Development Cooperation dhe i zbatuar nga 3 organizata, përkatësisht: Swiss Intercooperation-Zvicër, ÖAR-Austri dhe Co-Plan-Shqipëri. Partnerët dhe përfituesit e drejtpërdrejtë të këtij programi janë Qarku Shkodër dhe Qarku Lezhë, Ministria e Brendshme dhe Departamenti i Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave. Objektivi i përgjithshëm i këtij programi është nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të balancuar socio-ekonomik në Qarqet ku operon.

Dy nga katër përbërësit kryesorë të këtij programi kanë në fokusin e tyre përkatësisht ngritje kapacitetesh në dy Qarqet në lidhje me planifikimin e zhvillimit rajonal, së bashku me funksione të tjera të deleguara, dhe planifikim zhvillimi rajonal gjithëpërfshirës kombinuar me procese buxhetimi. Në këtë kuadër, grupi i punës i RDP ka punuar ngushtësisht me të dy Qarqet për të identifikuar nevojat për asistencë në çështjet e zhvillimit rajonal dhe të ngritjes së kapaciteteve që këto Qarqe kanë. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, është hartuar ky dokument, që ka për qëllim lehtësimin e zbatimit dhe të monitorimit të Konceptit Strategjik të Zhvillimit Rajonal (KSZHR) të Qarkut Lezhë¹.

“Skenarët e zhvillimit nënrajonat në Qarkun Lezhë” ka për qëllim që të sjellë së bashku objektivat e përgjithshme dhe sektoriale zhvillimore të prezantuara në disa dokumente strategjike të Qarkut Lezhë, të hartuara nga Këshilli i Qarkut apo aktorë të tjerë, dhe të mbështesë zbatimin e tyre përmes lidhjes së tyre me potencialet e zhvillimit territorial. Procesi i filtrimit të këtyre strategjive dhe i identifikimit të territoreve me potenciale të ngjashme zhvillimore ka shërbyer si platformë për hartimin e skenareve të zhvillimit të nënrajoneve. Këto skenare zhvillimi të nënrajoneve kanë qenë baza kryesore për identifikimin e projekteve-pilot, të cilat synojnë të nxisin zhvillimin rajonal/nënrajonat dhe janë përfshirë në Planin Veprimi të Qarkut Lezhë për periudhën kohore 2015-2017, i cili do t’i shërbejë Këshillit të Qarkut Lezhë për të orientuar punën në funksion të zbatimit të KSZHR-së përmes projekteve konkrete me qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm rajonal. Ky plan veprimi do të shërbejë gjithashtu si një instrument që ndërlihd parashikimet e dokumenteve strategjike me potencialet e zhvillimit ekonomik në territorin që ky institucion administron. Përveç Planit të Veprimi, ky dokument paraqet gjithashtu një metodologji përmes së cilës Këshilli i Qarkut mund të monitorojë dhe vlerësojë ecurinë e zbatimit të KSZHR-së.

1 Hartuar nga Këshilli i Qarkut Lezhë me mbështetjen e GIZ-it.

Fjala Përshëndetëse

Të nderuar lexues!

Kam kënaqësinë e veçantë të prezantoj para jush “Skenarët e zhvillimit nënrajonal në Qarkun Lezhë”, dokument që përfaqëson një qasje strategjike dhe territoriale të integruar të zhvillimit social-ekonomik të Qarkut Lezhë shoqëruar me plan veprimi konkret. Hartimi i këtij dokumenti u përgatit nga Këshilli i Qarkut Lezhë në kuadër të zbatimit të Programit për Zhvillimin Rajonal të Shqipërisë së Veriut (RDP) dhe shënon një përvojë pozitive në kuadër të planifikimit rajonal dhe të sintetizimit të strategjive ekzistuese.

Për hartimin e këtij dokumenti u mbështetëm fort në bibliotekën e studimeve dhe të strategjive të miratuara në vite nga Këshilli i Qarkut Lezhë. Përpos kësaj, nëpërmjet takimeve, seminareve dhe workshop-eve me grupet e interesit dhe gjithë aktoret kyç të zhvillimit rajonal identifikua nevojën për të shoqëruar dokumentet tona strategjike me studime territoriale, mbi të cilat mbështeten nismat për të konkretizuar ndërhyrjet në këtë territor. Qëllimi i këtij dokumenti është identifikimi i nënrajoneve me potenciale të ngjashme zhvillimi, hartëzimi i tyre dhe më pas hartimi i Planit të Veprimit përmes projekteve pilote, si dhe lehtësimi i monitorimit të zbatimit të tyre. Përvoja e krijuar gjatë zbatimit të projekteve të fondit të RDP-së, trajnimet e ekspertëve për përvetësimin e metodologjisë së hartimit, vlerësimit dhe zbatimit të projekteve ka bërë që kapacitetet tona rajonale të jenë të afta për zbatimin e këtij dokumenti dhe kjo për ne është shume e rëndësishme.

Në hartimin e këtij dokumenti, përveç ekspertëve të Këshillit të Qarkut Lezhë, dhanë kontributin e tyre shumë të çmuar edhe ekspertët e Drejtorive rajonale, përfaqësues të Njësive Vendore të Qarkut Lezhë, specialistë të fushave të ndryshme, shoqëria civile, përfaqësues të ndryshëm të shtresave në nevojë, përfaqësues të biznesit e në mënyrë të veçantë ekspertët me shumë përvojë të Co-Plan-it të cilët i falënderoj. Faktor i rëndësishëm për arritjen e suksesshme mbetet bashkëpunimi i pandërprerë midis aktorëve dhe faktorëve të zhvillimit lokal e rajonal si dhe mbështetja e donatorëve. Për këtë arsye Këshilli që unë kryesoj i shpreh mirënjohje të thellë Agjencisë Austriake për Zhvillim (Austrian Development Agency-ADA) dhe Bashkëpunimit Zvicerian për Zhvillim (Swiss Development Cooperation – SDC). Ne do të dëshironim që Programi i Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë e Veriut të vazhdojë bashkëpunimin me dy qarqet veriperëndimore të Shqipërisë, Shkodrën e Lezhën.

Zbatimi me sukses i këtij dokumenti do ta pozicionojë Qarkun e Lezhës në radhën e rajoneve të zhvilluara të Shqipërisë me cilësi jetese të lartë dhe të udhëhequra nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Me mirënjohje e respekt,

Pashk GJONI

Kryetar i Këshillit të Qarkut Lezhë

Shkurtime

AAZh	Agjencia Austriake për Zhvillim
AZhR	Agjencia e Zhvillimit Rajonal
BE	Bashkimi Evropian
DLDP	Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal në Lezhë dhe Shkodër
ERDI	Instituti i Zhvillimit Mjedisor dhe Rural
EURADA	Shoqata Evropiane e Agjencive Zhvillimore
FShZh	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
FZhR	Fondi i Zhvillimit Rajonal
GIS	Sistemet e Informacionit Gjeografik
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumentet e Asistencës së paraanëtarësimit
ISD	Mbështetje e Integruar për Decentralizim
IT	Teknologjia e Informacionit
KAZh	Kooperacioni Austriak Për Zhvillim
KE	Këshilli i Evropës
KSZHR	Koncepti Strategjik i Zhvillimit Rajonal
MADA	Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore
MBNj	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
METE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MoF	Ministria e Financës
Mol	Ministria e Brendshme
NjQV	Njësi të Qeverisjes Vendore ²
QGJS	Programi kompjuterik Sistemet e Informacionit Gjeografik Quantum
OJQ	Organizatë jo -Qeveritare
QSh	Qeveria e Shqipërisë
OShC	Organizata të Shoqërisë Civile
ÖAR	ÖAR Regionalberatung GmbH
PBA	Program Buxhetor Afatmesëm

2 Siç përcaktohen në ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore".


PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PLGP	Programi për Planifikim dhe Qeverisje Vendore
RDP	Programi i Zhvillimit Rajonal në Shqipërinë e Veriut
RDP NA	Programi i Zhvillimit Rajonal në Shqipërinë e Veriut
RDPF	Fondi i Programit të Zhvillimit Rajonal në Shqipërinë e Veriut
SAA	Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim (me BE)
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SMT	Grupet Tematike
SPVD	Strategjia e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit
SËOT	Pikat e Forta e të Dobëta, Mundësitë, Kërcënimet
ShBSh	Shoqata e Bashkive të Shqipërisë
ShKSh	Shoqata e Komunave të Shqipërisë
ShRSh	Shoqata e Rajoneve të Shqipërisë
ShShM	Shoqata Shqiptare e Marketingut
TR	Termet e Referencës
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
ZhR	Zhvillim Rajonal

I. Panorama e Përgjithshme

a. Përshkrim i shkurtër i Qarkut të Lezhës

Qarku i Lezhës shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë, me një sipërfaqe totale prej 1,620 km² dhe popullsi prej 134 027 banorësh³. Qarku i Lezhës kufizohet nga Qarku i Shkodrës në veri, nga Qarku i Kukësit në verilindje, nga Qarku i Dibrës në juglindje, nga Qarku i Durrësit në jug dhe nga deti Adriatik në perëndim. Pozicionimi strategjik i Qarkut Lezhë vitet e fundit është bërë akoma më i favorshëm, me ndërtimin e korridorit Durrës – Prishtinë – Nish, i cili kalon nga Qarku Lezhë dhe kryqëzohet me aksin kombëtar Tiranë-Shkodër në Milot. Aksesit ndaj Qarkut Lezhë pritet të rritet akoma më tej me konsolidimin e rrjetit rrugor ekzistues në një korridor të rëndësishëm ndërkombëtar adriatiko-jonian, i njohur ndryshe si Korridori i Kaltër⁴. Kështu, kryqëzimi i këtyre dy korridoreve ndërkombëtare që lidhin Shqipërinë me vendet e tjera të Ballkanit Jugperëndimor, së bashku me prezencën e portit të Shëngjinit si dhe afërsinë me aeroportin e Rinasit, e kthejnë Qarkun Lezhë në një zonë mjaft tërheqëse në pikëpamjen e zhvillimit ekonomik.

Harta 1. Pozicionimi strategjik i Qarkut Lezhë në Ballkanin Jugor⁵



³ Instat (2011), Censuri i popullsisë dhe i banesave.

⁴ Albanian Construction Portal (<http://acp.al/>)

⁵ Harta-bazë marrë nga RDP/Co-Plan, (2014), përditësuar nga Co-Plan/Këshilli i Qarkut Shkodër dhe Këshilli i Qarkut Lezhë gjatë hartimit të dokumenteve "Paketa e masave dhe e projekteve për zbatimin dhe monitorimin e KSZHR-së" për këto dy qarqe.

Studimi "Pabarazitë Rajonale në Shqipëri"⁶ ka vlerësuar rreth 50 indikatorë socio-ekonomikë, hapësinorë, financiarë dhe demografikë, mbi të cilët ka ndërtuar modelin e vlerësimit të pabarazive ndërmjet rajoneve (Qarqeve) në Shqipëri. Sipas këtij studimi, përsa i përket tipologjisë hapësinore, Qarku Lezhë ka pozicionim mesatar në raport me Qarqet e tjera, duke nënkuptuar aksesueshmëri të ulët, por në përmirësim, dhe duke theksuar diferencat në akses mes qendrave urbane dhe vendbanimeve më të shpërndara në pjesë me relieve më të vështira në këtë qark si dhe fragmentim të lartë të zonave të urbanizuara. Ndërsa përsa i përket aspekteve të tjera që kanë të bëjnë me zhvillimin rajonal, Qarku Lezhë renditet i teti, me indikator të barabartë me Qarkun Fier, sipas indeksit të Zhvillimit Rajonal⁷.

Megjithëse me përqindje papunësie afatgjatë jo shumë të lartë krahasimisht me qarqet e tjera, Qarku Lezhë renditet i nënti përsa i përket Prodhimit të Brendshëm Bruto/ frymë (PBB/frymë) – 1,933 euro/frymë⁸. Kjo mund të interpretohet si rezultat i një performace ekonomike të ulët të këtij qarku, e cila mbështetet kryesisht në bujqësi bazike (prodhim lënde të parë, me pak iniciativa në fushën e përpunimit të produkteve dhe të hallkave të tjera të zinxhirit të prodhimeve bujqësore) me rreth gjysmën e të punësuarve (48% në vitin 2007) në këtë sektor. Kjo përqindje, megjithëse ka pësuar rënie të konsiderueshme gjatë viteve të fundit, është indikator i cili tregon qartë shfrytëzimin e ulët të potencialeve të tjera që ofron qarku, kryesisht në sektorin e turizmit.

Sipas ndarjes administrative të vitit 2000⁹, Qarku Lezhë përbëhet nga 3 rrethe: Lezhë, Mirditë dhe Kurbin dhe 21 Njësi të Qeverisjes Vendore (NjQV), nga të cilat 5 bashki dhe 16 komuna¹⁰.

Qarku i Lezhës ka qenë një zonë me ekonomi kryesisht industriale (miniera, industri ushqimore, kimike, etj.) e mbështetur nga aktivitetet bujqësore deri në fillim të viteve '90. Me ndryshimet socio-ekonomike të këtyre viteve, roli i industrisë në zhvillimin ekonomik të qarkut filloi të zbehet, duke u fokusuar kryesisht në industrinë e ndërtimit dhe rol më të gjerë ekonomik mori sektori i bujqësisë dhe i peshkimit, kryesisht në zonën perëndimore të qarkut, ku shtrihen tokat bujqësore me bonitet më të lartë të këtij qarku. Për pasojë, lëvizjet migratore të popullsisë pas viteve '90 qartësisht tregojnë tkurrje të vendbanimeve ekonomia e të cilave ishte e fokusuar në industri, siç tregohet në hartën e mëposhtme, kryesisht në njësitë Ungrej, Kaçinar, Orosh dhe Selitë. Megjithëse lëvizjet migratore kanë qenë kryesisht të orientuara jashtë Qarkut Lezhë, me fokus rajonin qendror Tiranë – Durrës, apo edhe jashtë Shqipërisë, një pjesë e popullsisë është zhvendosur në pjesën

6 UNDP/EU, (2010), Pabarazitë Rajonale në Shqipëri (Regional Disparities in Albania), publikuar në kuadër të projektit "Duke punuar për Zhvillimin Rajonal" (Working for Regional Development).

7 I përlogaritur në bazë të një sere indikatorësh si: PBB/frymë, tregues bazë (që i referohen infrastrukturës rrugore, shërbimeve shëndetësore dhe arsimore, shërbimeve të furnizimit me ujë), tregues të përmirësuesit të efikasitetit (tregues për biznesin, papunësinë) dhe tregues në lidhje me faktorët e inovacionit (numri i markave tregtare, shpenzime për zhvillim dhe kërkim), (burimi: "Pabarazitë Rajonale në Shqipëri").

8 Në vitin 2007, sipas studimit "Pabarazitë Rajonale në Shqipëri" (Regional Disparities in Albania).

9 Ligji nr. 8652 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", datë 31.07.2000.

10 Me 31.07.2014 Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". Sipas këtij Ligji, Qarku Lezhë do të ketë 3 Njësi të Qeverisjes Vendore, përkatësisht:

-Lezhë: që do të përfshijë njësitë Lezhë, Shëngjin, Zejmen, Shënkoll, Baldren, Kallmet, Blinisht, Dajç, Ungrej, Kolsh.

-Mirditë: që do të përfshijë njësitë Rrëshen, Rubik, Selitë, Kthellë, Fan, Orosh, Kaçinar.


-Kurbin: që do të përfshijë njësitë Laç, Mamurras, Fushë-Kuqe, Milot.

Kjo ndarje e re do të zbatohet pas zgjedhjeve të ardhshme vendore, në Qershor të vitit 2015. Ky ligj i paraqet qarqet me kufijtë aktualë që ato kanë. Në vijim ky ligj do të shoqërohet edhe me dy ligje të tjera të rëndësishme: një ligj për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore dhe një ligj për decentralizimin fiskal. Këto tri ligje përbëjnë bazën mbi të cilën po reformohet qeverisja vendore, reformë, e cila padyshim prek edhe qarkun, edhe rolin që ky institucion do të ketë. Megjithëse ky dokument është hartuar pa u përmbyllur ende reforma dhe duke marrë parasysh kufijtë administrativë e funksionet ekzistuese të pushtetit vendor, zbatueshmëria e tij do të jetë e njëjtë edhe pas zbatimit të reformës, meqenëse metodologjia e ndjekur bazohet në analizat e potencialeve nënrajonale, përtej kufijve administrative, në funksion të zhvillimit ekonomik.

Harta 2. QARKU LEZHË - Kufijtë Administrativë të Njësisë të Qeverisjes Vendore (© Co-Plan)



perëndimore të qarkut, kryesisht në njësitë Lezhë, Shëngjin dhe Shënkoll, në të cilat brenda dhjetëvjeçarit 2001-2011 ka pasur një rritje populsië deri në 50%. Gjatë kësaj periudhe, krahas sektorit bujqësor, rëndësi për ekonominë e Qarkut Lezhë ka marrë edhe sektori i turizmit, me fokus turizmin bregdetar.

Harta 3. Ndryshimi i popullsisë 2001-2011, sipas komunave/bashkive¹¹

Të gjithë këta faktorë, janë ndikuar dhe kanë ndikuar edhe në shpërndarjen e infrastrukturës fizike në Qark, me përqendrim të shërbimeve në pjesën perëndimore të Qarkut, si pasojë e përqendrimit më të lartë të popullsisë në këto zona. Të gjitha këto dinamika rrisin sfidën për nxitjen e një ekonomie të qëndrueshme dhe të një rajoni konkurrues, si dhe nënvizojnë rëndësinë për hartimin dhe zbatimin e politikave të qëndrueshme të Zhvillimit Rajonal për Qarkun Lezhë.

Aktualisht Qarku Lezhë disponon disa dokumente strategjike, të cilat orientojnë prioritetet zhvillimore të këtij qarku. Ndër këto dokumente, të cilat do të përmblihen më poshtë, dokumenti me titull "Koncepti i Zhvillimit

11 Fragment harte nga: Instat, (2014), Popullsia dhe dinamikat e saj - Horizonte të reja demografike?

Rajonal të Qarkut Lezhë”, i hartuar nga Këshilli i Qarkut Lezhë me mbështetjen e GIZ-it në vitin 2010, është ai më gjithëpërfshirësi dhe më i përditësuar, të cilit ky institucion i referohet. Megjithatë ky dokument mbetet një Koncept Strategjik, i pashoqëruar me një *plan veprimi* mbi të cilin të mbështeten drejtpërdrejt përpjekjet e qarkut për ta zbatuar. Po ashtu, këtij dokumenti i mungon një *metodologji monitorimi* për të mbikëqyrur zbatimin e tij. Në përbushje të këtyre dy nevojave kryesore të Qarkut Lezhë, është hartuar dokumenti që po ju prezantojmë, “Skenarët e Zhvillimit Nënrajonal të Qarkut Lezhë”, si rezultat i një pune të përbashkët mes Këshillit të Qarkut Lezhë dhe programit RDP.

b. Roli i Qarkut, funksionet dhe nevoja për qeverisje rajonale

Kushtetuta e Shqipërisë¹² përcakton qarkun si njësi të qeverisjes vendore, megjithëse me funksione të ndryshme nga bashkitë dhe komunat. Sipas nenit 110 të Kushtetutës, përcaktohet funksioni kryesor i qarkut, si: *“Njësia ku ndërtohen e zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore”*. Më specifikisht, funksionet e qarkut, si nivel i dytë i qeverisjes vendore, janë të përcaktuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”¹³ si dhe në ligjet sektoriale, sipas rastit. Edhe në ligjin e sipërcituar, roli i qarkut fokusohet në hartimin e në zbatimin e politikave rajonale dhe në harmonizimin e tyre me politikat shtetërore, në të gjitha funksionet dhe kompetencat që mund t’i delegohen nga njësitë e tjera vendore (bashkitë dhe komunat) dhe nga qeveria qendrore.

Fillimisht, në vitin 2000 Qarku u konceptua si një institucion, i cili do të koordinonte punën e disa Njësive të Qeverisjes Vendore (bashkive dhe komunave) të ndodhura brenda territorit administrativ të Qarkut, në kuadër të reformës së decentralizimit të pushtetit vendor. Megjithatë, edhe sot Qarqeve u mungojnë kompetencat e duhura për të përbushur funksionet e tyre, të cilat në disa raste janë të paqarta ose të mbivendosura me funksione të institucioneve vendore apo të institucioneve qendrore në nivel vendor. Gjithashtu, burimet e financimit të këtij institucioni, kushtëzojnë në mënyrë të konsiderueshme zbatimin e funksioneve të sipërcituara. Sipas nenit 18, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Qarku krijon të ardhura nga burimet e veta vendore dhe nga ndarja e të ardhurave kombëtare, e më specifikisht:

- Të ardhurat nga burimet e veta vendore përbëhen nga:
 - a) transfertat e pakushtëzuara, përfshirë kuotat e anëtarësisë së komunave dhe të bashkive përbërëse.
 - b) transfertat e kushtëzuara për kryerjen e funksioneve dhe të kompetencave të deleguara përkatëse nga bashkitë dhe komunat përbërëse (kur delegohen përgjegjësi).
 - c) taksa dhe tatime të vendosura në nivel qarku, të përcaktuara në përputhje me ligjin.
 - d) tarifatat për shërbimet publike të kryera nga qarku.

Kriteret dhe normat për krijimin dhe administrimin e të ardhurave nga burimet e veta vendore janë të ngjashme me ato të përcaktuara për të ardhurat nga burimet vendore të komunave dhe bashkive. Gjithashtu të ardhurat e qarkut nga qeveria qendrore krijohen dhe administrohen sipas të njëjtës logjikë të ndjekur për njësitë vendore dhe konkretisht: transfertat e pakushtëzuar dhe Fondi i Zhvillimit të Rajoneve që ka zëvendësuar grantet konkurruese.

Megjithëse teorikisht kjo mënyrë financimi ngjan me atë të nivelit vendor të qeverisjes, në terma sasiorë buxheti i qarkut është mjaft i pakrahasueshëm me funksionet që ky institucion duhet të përbushë. Taksat, tatimet dhe tarifatat e vendosura në nivel qarku janë shumë të limituara. Në të njëjtën kohë, edhe aksesit i qarqeve në skemat e granteve konkurruese ka qenë në rënie, si rezultat i rënies së rolit të qarkut për investime në fushën e edukimit, shëndetit, shërbimeve sociale etj. Kështu për shembull, në vitin 2006 përqindja e

¹² Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor.

¹³ Ligji 8652 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” 31.07.2000.

granteve konkurruese që i është dhënë Këshillave të Qarqeve ka qenë 43% e totalit, ndërkohë që në vitin 2007 ka rënë në 15% dhe në vitin 2008 në vetëm 3%¹⁴.

Prandaj perceptimi i përgjithshëm është që aktivitetet zhvillimore të këtij institucioni gjithmonë e më shumë do të mbështeten mbi burime të jashtme financimi si: huamarrje dhe financime të donatorëve të ndryshëm¹⁵. Qarqet janë kryesisht të interesuar në hartimin e strategjive të zhvillimit rajonal, si dhe për zhvillimin, promovimin e territorit e zbatimin e këtyre strategjive përmes projekteve. Megjithatë kjo situatë buxhetore ndikon drejtpërdrejt në mundësitë e Qarkut për hartim dhe sidomos zbatim të strategjive të zhvillimit rajonal, duke krijuar kryesisht vështirësi në përgatitje projektsh dhe në financimin apo bashkëfinancimin e tyre (që shpesh është kusht i domosdoshëm nga shumë donatorë). Kështu që në përmbushje të funksionit të vet kryesor, si njësi ku ndërtohen e zbatohen politikat rajonale dhe harmonizohen me politikën shtetërore, një pjesë e madhe e qarqeve në Shqipëri, përfshirë Qarkun Shkodër dhe Lezhë, kanë hartuar dokumente që orientojnë zhvillimin strategjik të qarkut. Këto dokumente, qofshin gjithëpërfshirëse apo sektoriale, synojnë të harmonizojnë prioritetet zhvillimore të qarkut me politikat vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare. Megjithatë, strategjitë ekzistuese nuk ndiqen me plane konkrete veprimi, të cilat mund të udhëheqin zbatimin e tyre, prandaj mbeten në nivel politikash përgjithësuese dhe të pazbatuara. Po ashtu, pavarësisht se në shumë ligje sektoriale shprehet detyrimi që kanë institucionet vendore në zbatimin e strategjive rajonale, Qarku nuk disponon instrumente për të siguruar ndjekjen dhe zbatimin e tyre në nivel vendor, duke rritur edhe njëherë domosdoshmërinë e hartimit dhe të zbatimit të projekteve rajonale nga ky institucion.

Pavarësisht se roli i Qarkut mbetet akoma i paqartë, ky dokument është hartuar në një periudhë shumë të rëndësishme për sa i përket rikonceptimit të qeverisjes në nivel vendor dhe rajonal, përmes hartimit dhe zbatimit të Reformës Administrative dhe Territoriale nga Qeveria Qendrore. Megjithatë Reforma nuk është shprehur qartë, akoma në momentin e hartimit të këtij dokumenti, në lidhje me rolin që do të ketë Qarku, studimet e bëra në kuadër të saj theksojnë nevojën e qeverisjes rajonale në Shqipëri. Në këtë këndvështrim, duhet theksuar ndryshimi mes nivelit të ndërmjetëm të qeverisjes dhe qeverisjes rajonale:

Këto dy nivele kanë ndryshime thelbësore konceptuale. Niveli i dytë i qeverisjes vendore, që “duhej/mund të kishte qenë” Qarku i sotëm, ka për qëllim të ofrojë ato shërbime publike që prekin drejtpërdrejt cilësinë e jetës së qytetarëve dhe që nuk arrijnë të krijojnë ekonomi shkalle në nivelin e parë. . . Niveli i ndërmjetëm i qeverisjes, ose Rajoni, në parim nuk i ka fokus (të drejtpërdrejtë) këto lloj shërbimesh bazë. Rajoni ofron funksione që në thelbin e tyre realizojnë një menaxhim të territorit dhe të burimeve me qëllim rritjen e zhvillimit ekonomik në mënyrë të qëndrueshme, pra duke mbrojtur burimet natyrore.¹⁶


Megjithatë është akoma e paqartë nëse dhe si do të organizohet niveli rajonal i qeverisjes në Shqipëri, dhe nëse ky rol do t'i atribuohet Qarkut, sërish ky dokument është shkruar në funksion të këtij niveli qeverisës dhe me fokus nxitjen e zhvillimit ekonomik rajonal në mënyrë të qëndrueshme. Ky dokument, si suplement i domosdoshëm i Konceptit të Zhvillimit Rajonal që Qarku disponon, siç do të shpjegohet edhe më poshtë, do t'i shërbejë institucionit, i cili do të merret me qeverisje rajonale (nëse do të ketë një të tillë pas zbatimit të Reformës Territoriale Administrative) ose Qarkut aktual, nëse do të ruhet status quo-ja. Në rastin e dytë, Qarku fokuson punën e vet në funksion të nxitjes së zhvillimit ekonomik rajonal, pavarësisht se ky nuk është shprehimisht funksioni kryesor i tij sipas legjisllacionit aktual. Po ashtu, në rastin e dytë, ky dokument do të shërbejë si *plan veprimi* për institucionin e qarkut, kryesisht për ato departamente të cilat kryejnë funksionet ekskluzive në qark, sipas organigramës së mëposhtme:

14 UNDP/EU, (2011) Shqipëria – kapacitetet e zhvillimit rajonal në bazë, “Një studim mbi vlerësimin institucional” (Albania – regional development capacities on the ground, An institutional assessment study)

15 Idem

16 RDP/Co-Plan, (2014), Rajonalizimi I Shqipërisë – Reforma qeverisëse, administrative dhe territoriale që I duhet Shqipërisë në nivel rajonal.

Grafiku 1 Organigrama e Qarkut Lezhë



c. Situata aktuale e planifikimit strategjik në Qark

Ky dokument do të shërbejë si suplement i domosdoshëm i dokumentit të “Konceptit të Zhvillimit Rajonal të Qarkut Lezhë”. Megjithatë ky dokument synon të harmonizojë gjithashtu edhe rekomandimet që burojnë nga dokumente të tjera strategjike, të cilat adresojnë çështjet e qeverisjes rajonale apo Qarkun Lezhë specifikisht; duke filluar nga dokumente strategjike që japin udhëzime për qeverisjen rajonale në vendet e Europës Juglindore dhe të Ballkanit Perëndimor deri tek dokumentet sektoriale, të cilat adresojnë një çështje të caktuar në Qarkun Lezhë.

Më poshtë do të jepet një përshkrim i shkurtër i dokumenteve të referuara:

- **Strategjia 2020 e Europës Juglindore: Punësimi dhe prosperiteti në një këndvështrim European (BE/Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal)¹⁷:**

Ky dokument është hartuar në vitin 2011, si përgjigje ndaj kërkesës së qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor, nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal në bashkëpunim me qeveritë e vendeve të këtij rajoni, në përgatitjen e një dokumenti për çështje që kanë të bëjnë me konkurrencën rajonale dhe strategjitë e rritjes. Ky dokument fokusohet në pesë shtylla të modelit të ri zhvillimor:

Rritje e Integruar – me fokus Tregjet Rajonale, ekonominë e orientuar drejt eksportit dhe investimeve të huaja etj.

Rritje e Zgjuar – me fokus rritjen e konkurrueshmërisë Rajonale, udhëheqjen nga njohuria e novacioni dhe të bazuar në kapitalin njerëzor, në teknologjitë e komunikimit modern dhe në industri kreative.

Rritje e Qëndrueshme – me fokus në infrastrukturën dhe energjinë e qëndrueshme, në përdorimin me efikasitet dhe me ndjeshmëri të burimeve, sidomos të atyreve natyrore.

Rritje Gjithëpërfshirëse – me fokus avancimin përtej një shoqërie përjashtuese drejt një situatë ku të gjithë përfitojnë nga zhvillimi në mënyrë të drejtë.

Qeverisje në funksion të rritjes - me fokus qeverisjen transparente, funksionale dhe efçente.

- **Strategjia e Bashkimit European për Eurorajonin Adriatik – Jon EUSAIR (BE/Adrigov Operational Plan)**
Eurorajoni Adriatik - Jonian (EAI) është një shoqatë e themeluar për promovimin e bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe ndërrajonal mes rajoneve dhe autoriteteve lokale të vendeve të pellgut të Adriatikut dhe

17 EU/Regional Cooperation Council, (2011), South East Europe 2020 Strategy – Jobs and Prosperity in a European Perspective.

të Jonit. Në këtë kuadër është hartuar Strategjia e Bashkimit Europian për Eurorajonin Adriatik-Jon EUSAIR, në të cilën theksohen 4 shtylla zhvillimore, të cilat janë marrë parasysh gjatë hartimit të Planit të Veprimit:

- Udhëzime për zhvillimin detar dhe të produkteve detare përmes risive;
- Lidhje e rajonit përmes transportit dhe infrastrukturës;
- Ruajtje, mbrojtje dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit;
- Rritja e atraktivitetit rajonal.

Rekomandimet specifike të disa prej këtyre shtyllave janë marrë parasysh gjatë vlerësimit të projekt-ideve pjesë e Planit të Veprimit të Qarkut Lezhë, kryesisht ato që kanë të bëjnë me udhëzimet për zhvillimin detar, për mbrojtjen dhe për përmirësimin e mjedisit dhe rritjen e atraktivitetit rajonal, në rastin konkret përmes turizmit.

Në nivel kombëtar, ka disa dokumente që adresojnë çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin rajonal apo sektorë specifikë që janë relevantë për qarkun. Dokumentet kryesore të referuara gjatë punës për hartimin e këtij dokumenti janë:

- **Draft-strategjia Kombëtare për Turizmin (Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit)**

Kjo draft – strategji e fokuson interesin e zhvillimit të sektorit të turizmit në 5 fusha kryesore:

- **Fusha kryesore 1:** Përzgjedhja strategjike e llojeve të turizmit dhe e produkteve turistike që do të krijohen.
- **Fusha kryesore 2:** Marketingu.
- **Fusha kryesore 3:** Krijohen kushtet e përgjithshme kryesore për lehtësinë e hyrjes, për informacionin dhe për sigurinë e vizitorëve.
- **Fusha kryesore 4:** Shërbimet cilësore.
- **Fusha kryesore 5:** Korniza institucionale dhe e zbatimit.

Skenarët e zhvillimit nënrajonal në lidhje me sektorin e turizmit si dhe Draft-strategjia Kombëtare për Turizmin kanë qenë dy faktorët kryesorë ndikues në procesin e përzgjedhjes së projekt-propozimeve pjesë e Planit të Veprimit për zbatimin e KSZHR-së të Qarkut Lezhë. Nga draft-strategjia, katër kanë qenë fushat kryesore tek të cilat janë fokusuar propozimet e Planit të Veprimit:

Fusha kryesore 1:

Përzgjedhja strategjike e llojeve të turizmit dhe e produkteve turistike që do të krijohen

Drejtimit strategjike të përcaktuara në këtë fushë janë turizmi bregdetar, turizmi kulturor, turizmi i natyrës dhe ai rural si dhe produkte të veçanta turistike. Të gjitha këto drejtime strategjike janë shoqëruar me masa strategjike përkatëse, që kanë të bëjnë me mirëmenaxhimin e destinacioneve, marketingun e tyre, ngritjen e një sistemi planifikimi për zonat turistike, nxitjen e krijimit të ambienteve tërheqëse në këto zona, pajisjen me infrastrukturën dhe sinjalistikën e nevojshme, mbështetjen e bizneseve që operojnë në këtë sektor, standardizimin dhe certifikimin e shërbimeve etj. Këto masa kanë qenë prioritare edhe gjatë përzgjedhjes së projekteve të sektorit të turizmit për Planin e Veprimit të Qarkut Lezhë.

Fusha kryesore 2:

Marketingu

Kjo fushë kryesisht i referohet masave strategjike që kanë të bëjnë me përmirësimin e strukturës së marketingut dhe të ekspertizës për të, me ndërmarrjen dhe përmirësimin e instrumenteve të planifikimit dhe të studimeve të tregut, me mbështetjen e punës profesionale në të gjitha nivelet, me veprimtaritë lidhur me marketingun dhe krijimin e produkteve të marketingut. Këto aspekte janë pjesë kyçe të disa projekteve të

përzgjedhura si pjesë e Planit të Veprimit të Qarkut Lezhë, me qëllim krijimin dhe promovimin e produkteve turistike, duke identifikuar dhe forcuar atraksionet turistike të nënrajoneve me potenciale më të larta për zhvillimin e turizmit në qark.

Fusha kryesore 3:

Krijohen kushtet e përgjithshme kryesore për lehtësinë e hyrjes, për informacionin dhe për sigurinë e vizitorëve

Kjo fushë parashikon kryesisht përmirësimin e lehtësisë së aksesit, shërbimet turistike për vizitorët në destinacionet dhe pikat kryesore turistike, zbatimin e kushteve dhe rregulloreve që garantojnë sigurinë dhe mbrojtjen e konsumatorit. Përsa i përket kësaj fushe, projekt-identetë e përzgjedhura në kuadër të zhvillimit të sektorit të turizmit si pjesë e Planit të Veprimit të Qarkut Lezhë, janë fokusuar në lehtësimin e aksesit përmes përmirësimit të infrastrukturave të gjelbra, me fokus infrastrukturën e pedalimit, sinjalistikën përkatëse dhe menaxhimin e vizitorëve në zonat e mbrojtura.

Fusha kryesore 4:

Shërbimet cilësore

Kjo fushë fokusohet në dy drejtime strategjike kryesore: Kushtet e përgjithshme, bashkëpunimi, standardet dhe cilësia mbështesin zhvillimin konkurrues të industrisë së turizmit në nivel kombëtar dhe destinacioni e kuadri për zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin e turizmit siguron ofertën për arsimim dhe trajnim për sektorët dhe aktorët kryesorë të turizmit në destinacionet kryesore. Projekt-propozimet e përzgjedhura si pjesë e Planit të Veprimit të Qarkut Lezhë, ndër të tjera, synojnë të nxisin zhvillimin e kapitalit njerëzor në sektorin e turizmit, në funksion të rritjes së cilësisë së produkteve turistike që ofron dhe do të ofrojë ky rajon.

Pra në përmbledhje: masat në të cilat është fokusuar Plani i veprimit të Qarkut Lezhë kanë të bëjnë kryesisht me ngritjen e një sistemi planifikimi për zonat turistike (me fokus nënrajonet me potencial turistik bregdetar dhe me interes të veçantë mjedisor) dhe rritjen e aksesit të tyre përmes infrastrukturës dhe sinjalistikës së nevojshme. Po ashtu, në nivel marketimi, fokusi ka qenë në krijimin e produkteve të reja turistike, të marketimit të tyre dhe të ngritjes së kapaciteteve në këtë aspekt. Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve, projektet e përfshira në planin e veprimit nuk janë fokusuar vetëm në kapacitetet, të cilat ndikojnë cilësinë e produkteve turistike, por edhe në ngritjen e kapaciteteve në funksion të rritjes së sigurisë së turistëve në këtë Qark.

- Plani Rajonal Shkodër – Lezhë 2005-2020 (KE/EPTISA)¹⁸

Ky plan rajonal synon të zhvillojë një qasje shumëdimensionale të zhvillimit rajonal, duke u fokusuar në pesë çështje kryesore:

1. Krijimi i parcelave të ndërtueshme, për të përmbushur nevojat zhvillimore aktuale dhe për t'u paraprirë atyre të ardhshme;
2. Infrastruktura strategjike (rrugë, transport publik, ujësjellës/kanalizime dhe energji);
3. Strategji e zhvillimit ekonomik si lokomotiva e përcaktimit të prioritetëve në dy çështjet e sipërpërmendura;
4. Strategji mjedisore për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm;
5. Zbatimi i propozimeve që ka të bëjë me organizimin institucional.

Ndonëse ky dokument është hartuar në një kontekst zhvillimor të ndryshëm nga i sotmi dhe mbështetet mbi hipoteza të pazbatuara në vijim, përsëri mbetet një dokument strategjik i rëndësishëm që ka analizuar disa koncepte zhvillimore të cilat kanë ndikuar dhe ndikojnë në zhvillimin e këtyre dy qarqeve:

¹⁸ Eptisa, (2006), Plani Rajonal për Shkodër-Lezhën 2005-2020

- Efekti i zonave “Ndërkufitare”
- Efekti i “Tiranës”

Këto dy efekte janë faktorë që kanë ndikuar në zhvillimin ekonomik të Qarkut Shkodër dhe Lezhë, duke rezultuar në tregues më të lartë ekonomikë në njësitë që janë ndërkufitare në Shkodër dhe në njësitë më në afërsi të Tiranës në Qarkun Lezhë, duke evidentuar gjithashtu edhe inferioritetin ekonomik të zonave më të izoluar. Në këtë fazë ky plan parashtron një nga dilemat kryesore të politikëbërjes: nëse lekët duhet të ndjekin nevojën: pra të fokusohen investimet në zonat më të margjinalizuara, apo nevoja duhet të ndjekë lekët: pra të investohet në zona me potencial më të lartë zhvillimi dhe kthyeshmëri të investimeve, që mund të kthehen në zona tërheqëse për migrim të brendshëm. Argumenti që prezanton ky plan në përgjigje të kësaj dileme është që në zonat drejt “tkurrjes” duhet lehtësuar zhvendosja e popullsisë ndërsa në zonat në rritje duhet mbështetur zhvillimi me qenë se në këto zona impakti i kësaj mbështetjeje do të jetë më i gjerë dhe më substancial. Për këtë arsye, mbështetja e ekonomisë vendase, me fokus korridorin Lezhë-Shkodër-Podgoricë, si konkurrues ndaj atij Lezhë-Tiranë që do të margjinalizonte Qarkun Shkodër, është më e volitshme, dhe prandaj resurset duhen përqendruar në këtë drejtim. Ky është koncepti kryesor që puna për hartimin e Planit të Veprimit me Qarkun Lezhë ka përqafuar, duke u fokusuar në ndërhyrje që do të maksimizojnë potencialet ekonomike ekzistuese në vend të ndërhyrjeve që synojnë të simulojnë potenciale që nuk ekzistojnë.

- **Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis (REC)¹⁹**

Objektivi i këtij Plani është mbështetja e Qeverisë për të përmbushur kriteret e zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë në përputhje me kërkesat e BE-së në fushën e mjedisit, me fokus kryesor deltën e lumit Drin në Qarqet Shkodër – Lezhë. Në këtë kuadër, ky plan ka analizuar dhe propozuar ndërhyrje strategjike në 6 fusha kryesore: Gjeologjia dhe Energjia, Hidrologjia, Agrikultura dhe Peshkimi, Biodiversiteti dhe Zonat e Mbrojtura, Planifikimi i territorit dhe Dinamikat njerëzore, si dhe Turizmi. Parashikimet e planit të veprimit të këtij dokumenti janë integruar me planin e veprimit të hartuar dhe të Qarkut Lezhë, përmes përfshirjes së disa projekt-propozimeve që vijnë nga Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis në Planin e Veprimit të Qarkut Lezhë, duke u fokusuar kryesisht në projekte që kanë të bëjnë me mbrojtjen e integritetit territorial dhe të biodiversitetit të sipërfaqeve pyjore; me zgjerimin e sipërfaqes së mbjellë; me menaxhimin e erozionit bregdetar në zonat e mbrojtura etj.

- **Studim mbi zonat funksionale në Shqipëri (DLDP)²⁰**

Studimi i hartuar në funksion të fazës së tretë të programit DLDP, ka për qëllim studimin e pesë Qarqeve në Shqipëri, duke aplikuar konceptin e Zonave Funksionale, si një ushtrim për identifikimin e NjQV-ve partnere, të cilat mund të bëhen qendrat e dinamikave të zhvillimit rajonal dhe mund të shërbejnë si modele për efikasitet në dhënien e shërbimeve publike. Koncepti i Zonave funksionale synon të identifikojë hapësira (të cilatdo nivel – vendor apo rajonal) ku ndodhin ndërveprime të caktuara, me karakter kryesisht socio-ekonomik, dhe të cilat jo domosdoshmërisht përkrijnë me ndarjet administrative apo historike. Me qëllim identifikimin e zonave funksionale në pesë qarqet e studiuara, disa indikatorë janë marrë parasysh: indikatorë ekonomikë me fokus punësimin dhe konsumin, indikatorë në lidhje me aksesin ndaj shërbimeve me fokus shëndetësinë dhe arsimin, indikatorë në lidhje me qeverisjen e me fokus bashkëpunimin ndërvendor.

Në përfundim të këtij studimi, është arritur konkluzioni që Qarku i Lezhës përbëhet nga katër Zona Funksionale, tre prej të cilave përkrijnë me kufijtë e rretheve ekzistuese: Lezhë (përfshijë komunat Dajç dhe Blinisht), Mirditë and Kurbin, qendrat respektive të të cilave janë: Lezhë, Rrëshen dhe Laç. Zona Funksionale e katërt, është ajo e Zadrimës, me qendër në Vaun e Dejës, të Qarkut Shkodër dhe në të mund të përfshihen edhe njësitë Dajç e Blinisht nga Qarku Lezhë. Këto përfundime janë marrë parasysh gjatë studimit të potencialeve nënrajonale të zhvillimit në Qarkun Lezhë.

¹⁹ REC (2006), Plani Rajonal i Veprimit në Mjedis – Delta e lumit Drin në Shkodër-Lezhë (Regional Environmental Action Plan - Drini River Delta Shkodra - Lezhe)

²⁰ DLDP (2014), Studimi mbi zonat funksionale në Shqipëri (Study on functional areas in Albania)

- **Koncepti strategjik i zhvillimit rajonal (GIZ/ Këshilli i Qarkut Shkodër)²¹**

Koncepti Strategjik i Zhvillimit Rajonal është hartuar nga Këshilli i Qarkut Lezhë, me mbështetjen e GIZ-it, si instrumenti kryesor i planifikimit strategjik që vendos bazat e formatimit dhe të formalizimit të marrëdhënieve administruese të procesit të zhvillimit. Plani i Veprimit dhe Metodologjia e Monitorimit që po prezantohen në këtë dokument, ndërtojnë mbi këtë Koncept Strategjik Zhvillimi Rajonal dhe synojnë të lehtësojnë zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të tij. Koncepti Strategjik i Zhvillimit Rajonal parashton pesë fusha veprimi, të cilat përkohën me prioritetet e zhvillimit të përcaktuara nga Këshilli i Qarkut Lezhë për territorin e administruar prej tij. Për secilën nga këto pesë fusha prioritare është përcaktuar qëllimi strategjik në nivel rajonal, si dhe masat e nënmasat në funksion të zbatimit të këtij Koncepti Strategjik. Fushat prioritare të përcaktuara nga KSZH-r-ja janë:

1. Bujqësi, pylltari dhe peshkim;
2. Edukim, kulturë, shëndetësi e përkujdesje sociale;
3. Zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura;
4. Mjedisi dhe Energjia;
5. Menaxhimi rajonal, konteksti i partneriteteve brenda dhe ndërrajonale dhe qeverisja e orientuar drejt qytetarit.

KSZH-r-ja e hartuar në vitin 2010, ka rezultuar vështirësisht i zbatueshëm. Kjo vjen kryesisht për dy arsye kryesore: 1 - ngarkesa e tepërt që ai paraqet duke pasur parasysh burimet njerëzore dhe financiare që qarku disponon dhe 2 - mospërcaktimi i instrumenteve specifike (projekteve) përmes të cilave do të zbatohen parashikimet e masave dhe nënmasave. Gjithashtu, ky Koncept Strategjik i Zhvillimit Rajonal nuk ka identifikuar Turizmin si një nga sektorët kyç të zhvillimit ekonomik rajonal. Me qëllim plotësimin e kuadrit të zhvillimit ekonomik, procesi i hartimit të Paketës së Masave dhe Projekteve në zbatim dhe monitorim të KSZH-r-së, është shfrytëzuar edhe për të bërë disa plotësime në vetë dokumentin e KSZH-r-së, në rastin konkret me shtimin e një fushe prioritare: "Sektori i turizmit, promotor i zhvillimit ekonomik vendor dhe rajonal". Gjithashtu, projektet e dhëna si shembuj në KSZH-r, nuk janë bërë pjesë e planit të veprimit dhe nuk paraqesin realisht projektet më prioritare për zbatim, por thjesht një shembull se si mund të hartohen projekte në kuadër të KSZH-r-së. Për këtë arsye, si dhe për të përditësuar Planin e Veprimit për institucionin e Qarkut, Këshilli i Qarkut Lezhë me mbështetjen e ekspertëve të RDP-së, ka hartuar këtë dokument që përmban një Plan të zbatueshëm Veprimi dhe Strategji Monitorimi për KSZH-r-në.

- **Strategjia e turizmit dhe agro-turizmit në Qarkun Lezhë²²**

Në vitin 2011, Këshilli i Qarkut Lezhë ka ndërmarrë iniciativën për hartimin e një dokumenti strategjik sektorial me fokus zhvillimin e turizmit. Ky dokument, paraqet një analizë të detajuar të aseteve turistike natyrore, historike/arkologjike, kulturore/etnografike dhe gastronomike të rajonit, si dhe gjendjen aktuale të sektorit të turizmit. Me përcaktimin e vizionit për zhvillimin e turizmit në Qarkun Lezhë, në këtë Strategji Turizmi janë përcaktuar edhe katër objektiva kryesore zhvillimore:

1. Zhvillimi i një turizmit të qëndrueshëm përgjatë gjithë vitit;
2. Zhvillimi i turizmit bregdetar, malor, etnografik dhe historik;
3. Promovimi i një imazhi pozitiv për Qarkun e Lezhës;
4. Zhvillimi i agroturizmit.

Dokumenti Paketa e Masave dhe e Projekteve për Zbatimin e KSZH-r-së të Qarkut Lezhë, është mbështetur në Strategjinë e Turizmit të Qarkut Lezhë, si gjatë analizimit dhe përcaktimit të nënrajoneve me potenciale të ngjashme zhvillimore në sektorin e Lezhës, ashtu edhe gjatë përzgjedhjes së projekt-ideve, të cilat do të jenë

21 GIZ/ Këshilli i Qarkut Shkodër (2010), Koncepti strategjik i zhvillimit rajonal (Strategic development concept)

22 Këshilli i Qarkut Lezhë (2011), Strategjia e Turizmit dhe e Agroturizmit në Qarkun Lezhë.

pjesë e Planit të Veprimit, në mënyrë që këto dy dokumente të jenë në të njëjtën linjë dhe Plani i Veprimit i prezantuar këtu, të shërbejë edhe si Plan Veprimi për zbatimin e Strategjisë së Turizmit, brenda afateve kohore dhe burimeve në dispozicion të Qarkut Lezhë.

- **Plani Rajonal për Pyjet dhe Kullotat e administruara nga Qarku Lezhë**

Ky dokument, i hartuar nga Këshilli i Qarkut Lezhë në bashkëpunim me ekspertë të fushës, synon të përcaktojë objektivat kryesore në funksion të mbrojtjes dhe të zgjerimit të pyjeve e të kullotave të administruara nga Këshilli i Qarkut Lezhë. Në këtë kuadër, pas një analize të gjendjes ekzistuese dhe të problematikave kryesore të këtij sektori në rajon, ky plan përcakton objektivat kryesore si më poshtë:

1. Sigurimi i integritetit territorial, ekologjik dhe i biodiversitetit të pyjeve;
2. Menaxhim efektiv, rritja e numrit të zonave të mbrojtura dhe integrimi i masave për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike
3. Ruajtje dhe promovim i ekoturizmit
4. Nxitja e përdorimit në mënyrë të qëndrueshme e burimeve pyjore dhe kullotave në rajon

Përcaktimet e këtij plani, janë marrë parasys gjatë hartimit të Planit të Veprimit. Dy objektivat e para, janë kanalizuar përmes integritetit të disa projekteve të hartuara nga UNDP-Projekti i Ndryshimit Klimatik në Planin e Veprimit. Objektiva e tretë është përfshirë si pjesë e rëndësishme e propozimeve në sektorin e turizmit në Planin e Veprimit, ndërsa objektiva e katërt është përfshirë në sektorin e bujqësisë në Planin e Veprimit.

- **Identifikimi dhe zbatimi i masave për përshtatje në deltat e lumenjve Drini dhe Mat²³**

Ky dokument ofron disa propozime për zbatimin e masave prioritare për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike të propozuara në kuadër të projektit "Identifikimi dhe Zbatimi i Masave për Përshtatje në deltat e lumenjve Drin dhe Mat". Ky projekt, i financuar nga Qeveria e Shqipërisë dhe UNDP-ja është fokusuar në rritjen e përshtatshmërisë së ekosistemeve dhe të gjallesave ndaj kërcënimeve që vijnë si pasojë e ndryshimeve klimatike. Në këtë dokument prezantohet një paketë prej 11 Projekt-Propozimesh, në deltat e lumenjve Drin dhe Mat.

1. Menaxhimi i erozionit detar;
2. Menaxhimi i ujit të pastër në zonat e mbrojtura të Kune – Vainit dhe Patokut;
3. Menaxhimi i ekosistemeve pyjore në zonat bregdetare;
4. Menaxhimi i kanalit të baticë/zbaticës në Lagunën e Cekës;
5. Menaxhimi i kanaleve të komunikimit në Ishullin e Kunes;
6. Mirëmbajtja e komunikimit mes lagunave të Cekës dhe Zajës, si dhe lagunës së Cekës dhe lumit Drin;
7. Mirëmbajtja e argjinaturave në Kune-Vain dhe Ishull Shëngjin;
8. Mirëmbajtja e argjinaturave në zonën e Tales;
9. Trajtimi i ujërave të ndotura në zonat e Deltave të Lumit Drin dhe Mat;
10. Mirëmbajtja e kanaleve të kullimit në zonat e Deltave të Lumit Drin dhe Mat;
11. Përgatitja e një studimi fizibiliteti për gjithë zonën e Deltave të Lumit Drin dhe Mat.

Këto projekte janë vlerësuar gjatë takimeve të zhvilluara me ekspertë të ndryshëm të fushës së mjedisit, prej të cilëve janë përzgjedhur disa, si pjesë e Planit të Veprimit që do të prezantohet në këtë dokument "Paketa e Masave dhe e Projekteve për Zbatimin e KSZR-së të Qarkut Lezhë", si ndër projektet më strategjike dhe në të njëjtën kohë të zbatueshme brenda intervalit kohor në të cilin shtrihet ky Plan Veprimi.

²³ UNDP-Programi për ndryshimet klimatike: "Identifikimi dhe Zbatimi i Masave për Përshtatje në Deltat e Lumenjve Drin dhe Mat".Projekt-propozime të bazuara në masat prioritare për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

d. Qëllimi i dokumentit “Skenarët e zhvillimit nënrajonat në Qarkun Lezhë” dhe metodologjia e hartimit të tij

Duke analizuar situatën zhvillimore të Qarkut Lezhë, dokumentet strategjike ekzistuese dhe funksionet e këtij institucioni, si rezultat i takimeve dhe i konsultimeve mes ekspertëve të programit RDP dhe të Këshillit të Qarkut Lezhë, u pa i nevojshëm hartimi i këtij dokumenti, që do t’i shërbejë Qarkut Lezhë si:

- Instrument që ndërlidh parashikimet e dokumenteve strategjike me potencialet e zhvillimit ekonomik në territorin që ky institucion administron;
- Plan Veprimi mbi të cilin institucioni i Këshillit të Qarkut do të orientojë veprimtarinë e vet për 3 vitet e ardhshme;
- Instrument për të monitoruar zbatimin e KSZHR-së.

Nevoja për të punuar dhe për të hartuar këtë dokument, ka ardhur si rezultat i disa faktorëve, të cilët ky dokument synon të adresojë. Fillimisht, institucioni i Këshillit të Qarkut Lezhë ka si një nga funksionet kryesore harmonizimin e politikave të nivelit qendror me atë vendor. Megjithatë, ndërsa ekzistojnë një sërë dokumentesh strategjike, që synojnë të udhëheqin zhvillimin e këtij qarku apo të sektorëve specifikë të tij, Këshillit të Qarkut Lezhë i mungon një Plan Veprimi, që t’i harmonizojë të gjitha këto dokumente strategjike, vertikalisht dhe horizontalisht.

Po ashtu, shumica e këtyre dokumenteve strategjike ekzistuese, përcaktojnë prioritetet zhvillimore të qarkut, sipas sektorit që ato mbulojnë apo në mënyrë gjithëpërfshirëse. Megjithatë, pjesa më e madhe e tyre, japin referenca të mjegullta në lidhje me identifikimin e potencialeve ekonomike në territor dhe hartimin e strategjive të zhvillimit ekonomik rajonal dhe nënrajonat me dimensionet territoriale përkatëse. Ky dokument, para së gjithash, ka identifikuar këto potenciale ekonomiko-territoriale, duke hulumtuar në dokumentet strategjike ekzistuese dhe përmes takimeve e konsultave me aktorë dhe specialistë të ndryshëm të Qarkut Lezhë. Mbi bazën e tyre, janë përcaktuar *nënrajonet me potenciale të ngjashme zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik*. Identifikimi i këtyre nënrajoneve dhe i skenarëve të mundshëm të zhvillimit të këtyre potencialeve ekonomike, është një element i domosdoshëm mbi të cilin mbështetet Plani i Veprimit, i cili propozon Projekte konkrete Zhvillimore Rajonale, të cilat do të shërbejnë si katalizatorë për nxitjen e këtyre potencialeve ekzistuese. Pra në këtë mënyrë, është synuar që Plani i Veprimit të mos jetë thjesht i përbërë nga një listë projektsh prioritare, por edhe t’i ndërlidhë këto projekte me njëri-tjetrin dhe me projekte të zbatuara më parë në terren, në funksion të një skenari zhvillimor nënrajonat.

Së fundmi, ky dokument shërben edhe si një instrument monitorimi i zbatimit të KSZHR-së, duke përcaktuar një metodologji, e cila do të aplikohet periodikisht nga Qarku, me qëllim matjen e suksesit në zbatimin e prioriteteve të përcaktuara.

II. Analiza Nënrajonale

a. Koncepti i “nënrajonit” dhe rëndësia e tij në planifikimin rajonal

Fillimisht është e rëndësishme të sqarohet diferenca e zbutjes së pabarazive rajonale përmes zhvillimit rajonal, përmes transfertave financiare të ndryshme dhe subvencioneve qeveritare, dhe qasja që ka ky dokument si një udhëheqës drejt zhvillimit të qëndrueshëm rajonal dhe nënrajonal. Zhvillimi rajonal përfaqëson kapacitetin e një rajoni në prodhimin dhe tregtimin e të mirave dhe të shërbimeve; ose thënë më thjesht: përfaqëson kapacitetin që kanë banorët e tij për të rritur të ardhurat. Zbutja e pabarazive rajonale përmes nxitjes së zhvillimit rajonal synon identifikimin e potencialeve ekonomike të rajonit dhe nxitjen e zhvillimit të tyre. Ndërsa zbutja e pabarazive rajonale përmes transfertave financiare, synon zbutjen e pabarazive të të ardhurave të banorëve në zona të ndryshme, por jo domosdoshmërisht zhvillim rajonal. Eksperiencia botërore në lidhje me transfertat financiare dhe subvencionet qeveritare që nuk marrin parasysh potencialet ekonomike konkrete të zonave drejt të cilave janë destinuar dhe synojnë të stimulojnë zhvillime ekonomike artificialisht, ka treguar që këto iniciativa janë jetëshkurtra dhe jo të qëndrueshme. Ndaj, identifikimi i potencialeve *ekzistuese* ekonomike është hapi i parë që duhet ndërmarrë kur bëhet fjalë për zhvillim ekonomik rajonal. Ky dokument, me qëllim hartimin e Planit të Veprimit të Qarkut, është hartuar duke synuar nxitjen e zhvillimit ekonomik rajonal si instrumenti më i qëndrueshëm për zbutjen e pabarazive në vend. Ndaj, identifikimi i potencialeve ekonomike dhe territoriale rajonale dhe nënrajonale dhe nxitja e tyre përmes projekteve pilote është në qendër të këtij dokumenti.

Zhvillimi rajonal është nga natyra sfidues dhe shumëdimensional. Për shkak të këtij kompleksiteti, analizat rajonale mund të orientohen drejt segmentimit sipas sektorëve të veçantë (ekonomikë, mjedisorë, socialë etj) si dhe sipas nënrajoneve të veçanta. Në kuptimin e këtij dokumenti, *nënrajon me potenciale të ngjashme zhvillimi ekonomik do të thotë identifikimi i sipërfaqeve territoriale, të cilat, pavarësisht përkatësive administrative, funksionojnë si njësi të integruara përsa i përket resurseve natyrore apo njerëzore që ato kanë në një sektor të caktuar. Identifikimi i këtyre nënrajoneve me potenciale të ngjashme për zhvillim është thelbësor në procesin e planifikimit rajonal, dhe është një funksion i rëndësishëm që mund të kryhet në nivel rajonal, si një parakusht për hartimin e skenareve të zhvillimit nënrajonal që plotësojnë strategjitë zhvillimore me dimensionin territorial.*

Tentativa për të studiuar qarkun përmes nënrajoneve nxitet nga disa arsye:

- Identifikimi i nënrajoneve me potenciale të ngjashme zhvillimi *rrit impaktin e projekteve*, të cilat mund të zbatohen në to, në funksion të potencialeve ekonomike që këto nënrajone kanë. Për shembull, zbatimi i një projekti me fokus ekoturizmin krijon efekt domino më të gjerë në një nënrajon ku ka potenciale për zhvillimin e ekoturizmit më shumë sesa në një nënrajon ku vetëm një njësi vendore e ka këtë potencial.
- Identifikimi i këtyre nënrajoneve lehtëson edhe *identifikimin e nevojave për bashkëpunim* ndërvendor apo ndërrajonal dhe koordinim në Qark.

- Meqenëse nënrajoni funksionon si një organizëm, identifikimi i tyre sjell edhe lehtësira në planifikimin e infrastrukturave dhe të transportit për këto zona, duke i bërë ato më kosto -efektive.
- Për zbutjen e pabarazive përmes identifikimit dhe maksimizimit të potencialeve ekonomike të aseteve ekzistuese në zona me burime të pakta ekonomike.

Me qëllim identifikimin e nënrajoneve me potenciale të ngjashme zhvillimore, si fillim grupi i punës pranë Këshillit të Qarkut Lezhë me mbështetjen e RDP-së identifikon sektorët kryesorë ekonomikë të këtij qarku. Sektorët e identifikuar përfshijnë: Bujqësi/Blegtori, Turizëm, Industri dhe Mjedis. Tre sektorët e parë përfaqësojnë sektorët kryesorë ekonomikë të këtij rajoni, me impakt të konsiderueshëm territorial. Përsa i përket sektorit industrial, fokusi ka qenë në rehabilitimin e ish-zonave industriale me qëllim zvogëlimin e impaktit mjedisor që ato kanë, meqenëse sektori i Industrisë është një sektor, i cili ndërlidhet ngushtë me politikën zhvillimore në nivel qendror, dhe roli i qarkut në nxitjen e zhvillimit të tij është i limituar. Megjithatë, procesi për hartimin e këtij dokumenti është shfrytëzuar edhe për të forcuar partneritetet e Qarkut me aktorë të tjerë vendorë dhe kombëtarë, dhe në këtë kuadër, qëllimi i Qarkut është që të vazhdojë këto bashkëpunime me nivelin qendror dhe të zbulojë mundësi të reja që përmes këtij partneriteti të ndikojë në zhvillimin e sektorit industrial, si një sektor i rëndësishëm për rritjen ekonomike të Qarkut Lezhë. Gjithashtu, me qëllim hartimin e projekteve sa më të qëndrueshme, si dhe në linjë me Konceptin Strategjik të Zhvillimit Rajonal të këtij qarku, grupi i punës vendosi të analizojë edhe aspektin mjedisor, duke identifikuar nënrajonet, të cilat kanë asete të rëndësishme natyrore dhe/ose nënrajone, të cilat ndajnë probleme të ngjashme mjedisore. Ndikimet territoriale të secilit sektor analizuan duke ndjekur metodologjinë dhe kriteret e prezantuara më poshtë, me qëllim identifikimin e nënrajoneve që ndajnë karakteristika të ngjashme në secilin sektor. Identifikimi i këtyre nënrajoneve u ndoq nga hartimi i skenareve të zhvillimit për secilin nënrajon të identifikuar në secilin sektor. Këto skenare zhvillimi, janë jo vetëm baza për përzgjedhjen apo hartimin e projekt-propozimeve që janë përfshirë në Planin e Veprimit të Qarkut Shkodër, por gjithashtu shërbejnë për të lidhur Konceptin e Zhvillimit Rajonal të Qarkut Shkodër me territorin. Ndërkohë që Koncepti i Zhvillimit Rajonal të Qarkut Shkodër ka identifikuar Fushat Prioritare të Zhvillimit dhe ka detajuar masat që duhet të ndërmerren. Skenarët e zhvillimit nënrajonal i lidhin këto masa me territorin ku ato mund të aplikohen për të arritur impakt sa më të konsiderueshëm rajonal/nënrajonal. Katër sektorët e përzgjedhur si tematika të analizave, përfshijnë në vetvete komponentë në përputhje me Fushat Prioritare të përcaktuara në KSZHR-në e Qarkut Lezhë. Ndërkohë KSZHR-së i është shtuar dhe një fushë tjetër prioritare, e cila përmendet edhe në dokumentin origjinal, por nuk zë vendin e duhur, duke iu referuar rëndësisë që ka për zhvillimin e Qarkut Lezhë, "Sektori i Turizmit, promotor i zhvillimit ekonomik vendor dhe rajonal". Në këtë mënyrë, analizat dhe më pas gjetjet, masat dhe projektet e këtij sektori lidhen me këtë fushë prioritare të identifikuar, por edhe me elemente të tjera që mund të kenë më tepër lidhje me fushën prioritare "Menaxhimi rajonal, konteksti i partneriteteve brenda dhe nder-rajonale dhe qeverisja e orientuar drejt qytetarit". Ndaj, qasja në nivel sektori nuk devijon nga qasja e përdorur gjatë hartimit të KSZHR-së, përkundrazi, synon të kombinojë disa aspekte të këtij dokumenti, për të arritur identifikimin e nënrajoneve me potenciale të ngjashme zhvillimore.

Qëllimi kryesor i këtij procesi ka qenë identifikimi i nënrajoneve me potenciale të ngjashme zhvillimi, hartimi i skenareve të zhvillimit dhe i mënyrave të ndërhyrjes në to, si dhe finalizimi i këtij procesi përmes identifikimit të projekt-ideve pilote në shërbim të nxitjes së zhvillimit ekonomik në këto nënrajone.

Për realizimin e këtij ushtrimi, në Qarkun Lezhë është hartuar një bazë të dhënash hapësinore duke përdorur programin Quantum GIS. Kjo bazë të dhënash synon dokumentimin dhe mbivendosjen e shtresave të ndryshme të informacionit, të cilat janë marrë parasysh gjatë analizave dhe përmes të cilave mund të identifikohen nënrajonet. Vlen të theksohet fakti që nënrajonet e identifikuara, nuk kanë të përcaktuar kufij të saktë gjeografikë, por zonimin e përafërt të sipërfaqeve, të cilat kanë potenciale të ngjashme ekonomike. Konfigurimet e nënrajoneve gjithashtu ndryshojnë në vartësi të sektorit në fjalë, pasi sektorët të ndryshëm krijojnë marrëdhënie të ndryshme territoriale.

b. Identifikimi i nënrajoneve dhe formulimi i skenareve të zhvillimit nënrajonat

Analizat për sektorët e specifikuar më sipër nuk kanë qenë ezauruese. Gjatë takimeve të ndryshme me aktorët kryesorë për secilin sektor, grupi i punës ka identifikuar disa variable për t'u analizuar, për secilin sektor. Këto variable janë vlerësuar duke përdorur literaturën ekzistuese si dhe përmes grupeve të diskutimit me ekspertë të fushës. Procesi i hartëzimit ka qenë një proces me pjesëmarrje, ndaj rezultatet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare reflektojnë informacion të integruar nga burime të ndryshme. Këto harta janë mbivendosur dhe interpretuar për të identifikuar nënrajonet. Variablet e konsideruara për secilin sektor janë si më poshtë:

Bujqësi/ Blegëtori

Ky sektor është analizuar duke u fokusuar në disa variable kryesore:

1. Potencialet natyrore: Mbulesa ekzistuese e tokës dhe potencialet bujqësore/blegtorale që ajo paraqet;
2. Infrastruktura bujqësore/blegtorale: Pikat e grumbullimit, dhomat frigoriferike, rezervate, pika përpunimi të qumështit etj²⁴;
3. Tregjet kryesore, dytësore dhe sezonale;
4. Produktet tipike të kultivuara/ të shfrytëzuara;
5. Infrastruktura rrugore/ aksesibiliteti dhe afërsia gjeografike.

Këta faktorë, të mbivendosur si shtresa të ndryshme informacioni në lidhje me sektorin, janë baza mbi të cilën janë analizuar dhe janë identifikuar potencialet bujqësore/blegtorale, të cilat mund të mbështeten më tej përmes projekteve të përzgjedhura në planin e veprimit.

Turizëm

Gjatë studimit të potencialeve nënrajonale në sektorin e turizmit janë rivlerësuar analizat e parashtruara kryesisht në dokumentin e "Strategjia e Turizmit dhe e Agriturizmit në Qarkun Lezhë" si dhe rezultatet e disa takimeve me ekspertë të ndryshëm në funksion të hartëzimit me pjesëmarrje. Megjithatë janë hartëzuar kryesisht asetet fizike në territor, pjesë e rëndësishme e analizës dhe identifikimit të nënrajoneve në këtë sektor kanë qenë edhe aspekte jofizike që kanë të bëjnë me kapacitetet njerëzore, trashëgiminë kulturore etj.

Ky sektor është analizuar duke u fokusuar në disa variable kryesore:

1. Asetet historike/ Kulturore – ku janë identifikuar asetet kryesore me rëndësi rajonale si objekte kulturi me vlera historike dhe kulturore, kala/kulla, varreza të vjetra, kisha etj. Në këtë rast janë identifikuar itineraret ekzistuese dhe/ose të mundshme për të nxitur krijimin e paketave turistike në këtë zonë dhe promovimin e tyre.
2. Asetet natyrore – ku janë identifikuar asetet natyrore si zonat e mbrojtura, zonat me interes të veçantë për ekosistemet që ato kanë, zona me peizazh të mbrojtur, monumentet natyrore etj. Edhe në këtë rast janë identifikuar itineraret e mundshme për t'i promovuar ato apo për hartimin e paketave të reja turistike.

Mjedis

Përsa i përket çështjeve mjedisore, grupi i punës ka identifikuar disa problematika dhe nevoja prioritare ndërhyrjesh, që kanë të bëjnë me përshtatjen e zonave me rëndësi të veçantë mjedisore ndaj ndryshimeve klimatike, me mbrojtjen e tyre nga ndotjet etj. Puna në këtë aspekt është fokusuar në variablet e mëposhtme:

24 Informacion i marrë nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe i përpunuar në hartë nga RDP/Co-Plan.

1. Zonat me rrezik ndotjeje/ kontaminimi (të ujërave sipërfaqësore/ nëntokësore – si rezultat i menaxhimit të dobët të mbetjeve të ngurta, të sistemit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, të ndotjes së tokës, të ndotjes së ajrit etj).
2. Zonat që kanë nevojë për masa për parandalimin e problemeve me erozionin, përmytjet dhe shpyllëzimin.
3. Zonat/elementet e mbrojtura natyrore me rëndësi të veçantë mjedisore.

Industri

Sektori i industrisë së rëndë, është një sektor, i cili për nga rëndësia që ka në nivel kombëtar, orientohet kryesisht nga politikat në nivel qendror. Megjithatë, roli i Qarkut si institucion që harmonizon politikat qendrore me ato në nivel vendor, kërkon që edhe në këtë rast ky harmonizim të realizohet, duke synuar koordinimin e zhvillimeve industriale me dy sektorët e tjerë të rëndësishëm ekonomikë të identifikuar në Qarkun e Lezhës: bujqësinë/blegtorinë dhe turizmin. Në nëntor të vitit 2014 pritet të publikohet nga Drejtoria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar një studim në lidhje me gjeomorfologjinë dhe hidrogeologjinë e Republikës së Shqipërisë, që do të shërbejë si bazë për hartimin e strategjive për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore nëntokësore. Megjithatë, në mungesë të këtij studimi, studimi i nënrajoneve është bërë duke u fokusuar në variablet e mëposhtme:

1. Zonat të cilat kanë ndikim negativ mjedisor nga veprimtaritë ekzistuese apo të shkuara në sektorin e industrial.
2. Zonat me potencial të lartë të zhvillimit të sektorit industrial.


Vlerësimi i kujdesshëm i këtyre variableve për secilin sektor i ka mundësuar grupit të punës identifikimin e nënrajoneve me potenciale të ngjashme zhvillimore:

Nënrajonet Bujqësore dhe Blegtorale:

Analizat e variableve të sipërpërmendura, janë paraqitur në hartat e mëposhtme, si pjesë e analizave të sintetizuara:

Harta 4. Studim i mbulesës së tokës për të kuptuar nënrajonet me potenciale bujqësore dhe blegtorale të ngjashme (© Co-Plan).

QARKU LEZHË - Potencialet bujqësore/blegtorale (Mbulesa e tokës)



Balldren, Dajç
Blinisht: 13268 Ha
tokë bujqësore

Balldren, Kallmet:
1400 Ha Kullota


Kolsh, Shëngjin,
Shënkoll, Zejmen,
Fushë Kuqe, Laç,
Mamurras: 24345 Ha
tokë bujqësore

Ungrej, Kaçinar:
3786 Ha Kullota


Orosh, Fan, Selite:
2649 Ha Kullota

Harta 5. Studim i infrastrukturës bujqësore, i tregjeve kryesore (majtas) dhe i produkteve tipike (djathtas) për të kuptuar nënrajonet me potenciale bujqësore dhe blegtorale të ngjashme (© Co-Plan).

QARKU LEZHË - Infrastruktura bujqësore dhe Tregjet kryesore



QARKU LEZHË - Produktet tipike



Nga kjo analizë, janë identifikuar nënrajonet e mëposhtme, me potenciale të ngjashme në zhvillimin e sektorit të bujqësisë/të blegtorisë:

1. *Nënrajonin e Zadrimës:* përfshin pjesë të njësive Dajç, Blinisht, Balldren, Kallmet dhe Ungrej. Në këtë nënrajon gjenden rreth 28 870 ha tokë bujqësore, kryesisht me bonitet të lartë (kategoria 1-4). Në këtë nënrajon vërehet një përqendrim i lartë i qendrave të përpunimit të qumështit. Gjithashtu nënrajonin njihet edhe për traditën në vreshtari, me disa subjekte të përpunimit të rrushit, si kantina e verës së Kallmetit, e cila është një nga markat e verës më të njohura në vend dhe më gjerë. Përveç këtyre produkteve, produkte të tjera tipike të zonës janë fruta/perimet (shëgë dhe shalqi në Balldren, arrat dhe gështenjat në Ungrej) fasulet e Kallmetit, gjeli i detit dhe ullishtet në Dajç dhe Kallmet, si dhe bimët medicinale, kryesisht në Balldren.

Skenari Zhvillimor i bujqësi/blegtorisë në nënrajonin e Zadrimës: Si nënrajon fqinj me Nënrajonin e Nën-Shkodrës në Qarkun Shkodër, dhe me të njëjtin profil zhvillimor, edhe ky nënrajon duhet të ndjekë një skenar të ngjashëm zhvillimi me të. Edhe në këtë rast, është e rëndësishme që sektori bujqësor të shihet si i ndërlidhur me sektorin e turizmit. Në këtë kontekst, ky nënrajon duhet të nxisë kultivimin dhe përpunimin e produkteve tipike, si element kyç të ekoturizmit, i cili do të jetë fokusi i zhvillimit ekonomik në këtë zonë. Ndërthurja e produkteve tipike (vera) dhe krijimi i ekofermave në fushën e Zadrimës, kombinuar me asetet historike/kulturore, do të krijojë një imazh shumë tërheqës për të apasionuarit pas ekoturizmit. Afërsia e këtij nënrajonin me zonat bregdetare më të frekuentuara në veri, si plazhi i Velipojës dhe ai i Shëngjinit, duhet të shërbejë si faktor nxitës që sektori bujqësor të shërbejë si sektor mbështetës i sektorit të turizmit. Gjithashtu, shtrirja e fushës së Zadrimës mes dy tregjeve mjaft të rëndësishëm në rajon, qyteti i Shkodrës dhe qyteti i Lezhës, dhe aksesit i lartë i kësaj zone, qoftë përmes rrugëve automobilistike dhe atyre hekurudhore, favorizon tregtimin e këtyre produkteve në rajon dhe më gjerë. Megjithatë, për shfrytëzim maksimal të këtyre mundësive për tregtim, është e nevojshme të bëhen përpjekje serioze në realizimin e infrastrukturave bujqësore me qëllim magazinimin dhe/ose përpunimin e produkteve bujqësore.

Përpjekjet për zhvillimin e këtij sektori duhet të fokusohen në:

- Zgjidhjen e problematikave që kanë të bëjnë me rrjetin kullues dhe ujitës;
- Mbështetjen e fermerëve në zgjerimin e kultivimit dhe tëmarketimit të produkteve tipike të zonës, siç përmenden më lart.
- Mbështetjen e fermerëve dhe informimin i tyre në lidhje me mundësitë e financimit nga skema mbështetëse të Qeverisë Shqiptare apo nga donatorë të ndryshëm;
- Konsolidimin e infrastrukturës bujqësore përmes ndërtimit të dhomave frigoriferike, magazinuese etj.

2. *Nënrajonin e Lezhë-Kurbinit:* përfshin pjesë të njësive Shëngjin, Shënkoll, Fushë Kuqe, Zejmen, Milot, Laç, Mamurras, Lezhë dhe Kolsh. Në këtë nënrajon gjenden rreth 36 296 ha tokë bujqësore, kryesisht me bonitet të lartë (kategoria 1-4) dhe kryqëzohen dy akset më të rëndësishme të veriut të Shqipërisë: Durrës-Kukës-Morinë dhe Tiranë-Shkodër-Podgoricë. Ky kryqëzim paraqet një njësi mjaft të rëndësishme, e cila mund të transformohet në një qendër të rëndësishme për magazinimin dhe/ose përpunimin e produkteve bujqësore/blegtorale për eksport jashtë vendit. Në të njëjtën kohë, pjesë e këtij nënrajonin është edhe porti i Shëngjinit, një tjetër pikë kyçe në eksportin e produkteve bujqësore/blegtorale. Me prezencën e këtyre dy pikave strategjike, ky nënrajon ka mundësi optimale për nxitjen e këtij sektori.

Skenari Zhvillimor i bujqësi/blegtorisë në nënrajonin e Lezhë-Kurbinit: Për të shfrytëzuar mundësitë që i janë krijuar si rezultat i aksesibilitetit të lartë në nënrajon, është e rëndësishme të ndërmerren masat e mëposhtme:


- Të forcohen partneritetet mes fermerëve dhe bizneseve që operojnë/mund të operojnë në të ardhmen në sektorin e bujqësi/blegëtorisë në këtë nënrajon. Forcimi i partneriteteve nënkupton orientimin e prodhimit bazë (lëndës së parë) nga kërkesat në industrinë ushqimore, duke siguruar tregje për shitjen e produkteve bujqësore për fermerët;
- Të investohet në zgjidhjen afatgjatë të problematikave që kanë të bëjnë me rrjetin kullues dhe ujitës në fushat bujqësore;
- Të investohet në plotësimin e nevojave për ndërtimin e Dhomave Frigoriferike dhe të Qendrave Magazinuese, me fokus zonat në afërsi të portit të Shëngjinit, të kryqëzimit të Milotit dhe të segmentit të rrugës lidhëse mes këtyre pikave.
- Të nformohen dhe të asistohen fermerët në lidhje me mundësitë për financim përmes skemave të Qeverisë Shqiptare apo Donatorëve të huaj;
- Të mbështetet industria e peshkut në zonën e Shëngjinit, me qëllim rritjen e lëndës së parë vendase dhe uljen e importimit të saj në pikat e përpunimit të peshkut në këtë nënrajon

3. *Nënrajon i Rubik-Rrëshen:* përfshin pjesë nga njësitë Rubik, Rrëshen dhe Kthellë. Ky nënrajon ka potenciale të limituara në zhvillimin e sektorit të bujqësi/blegëtorisë, megjithatë nxitja e këtij sektori për plotësimin e nevojave të tregut të Mirditës ndihmon në ekonominë lokale.

Skenari Zhvillimor i bujqësi/blegëtorisë në nënrajonin e Rubik-Rrëshenit: Për nxitjen e këtij sektori në këtë nënrajon duhet të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Mbështetja e fermerëve në zgjerimin e kultivimit dhe të marketimit të produkteve tipike të zonës, kryesisht të vitikulturës (Vera e Arbërit);
- Mbështetja e fermerëve dhe informimi i tyre në lidhje me mundësitë e financimit nga skema mbështetëse të Qeverisë Shqiptare apo nga donatorë të ndryshëm;
- Konsolidimi i infrastrukturës bujqësore përmes ndërtimit të dhomave frigoriferike, magazinuese etj.

Harta 6. Nënrajonet me potenciale të ngjashme zhvillimi në sektorin bujqësor (© Co-Plan).



1- Nënrajon i Zadrimes: (Nënrajon me potencial të lartë në sektorin e bujqësisë) Nderthurje e investimeve bujqësore me ato me karakter turistik. Zgjidhje e problematikave që kanë të bëjnë me kullimin dhe ujitjen. Investime në infrastrukturën bujqësore (magazinim) dhe ngritje kapacitetesh.


2- Nënrajon i Lezhë-Kurbinit : (Nënrajon me potencial të lartë në sektorin e bujqësisë) Mbështetje e potencialeve të peshkimit dhe fruta/perimeve në zone. Zgjerimi i tregut të produkteve bujqësore. Zgjidhje problematikave të kullimit dhe ujitjes. Ngritje kapacitetesh në lidhje me zhvillimin e cendrueshëm të bujqësisë në zonat e mbrojtura

3- Nënrajon i Rubik-Rrëshen: (Nënrajon me potencial të moderuar në sektorin e bujqësisë) Mbështetje e vreshtarise. Ngritje kapacitetesh. Mbështetje e infrastrukturës bujqësore (magazinuese)

Nënrajonet e turizmit



Sërish, variablet e identifikuara përmes takimeve me aktorët kyç të sektorit, janë hartëzuar përmes proceseve me pjesëmarrje, siç tregohen në hartat e mëposhtme:

Harta 7. Studimi i aseteve historike për të kuptuar nënrajonet me potenciale të ngjashme zhvillimi për sektorin e turizmit (© Co-Plan).



Harta 8. Studimi i aseteve natyrore për të kuptuar nënrajonet me potenciale të ngjashme zhvillimi për sektorin e turizmit (© Co-Plan).

QARKU LEZHË - Asetet natyrore



Zona me rëndesi të vecante mjedisore
 Peisazhe të mbrojtura (Ballëren-shtrati i lumit Buna - Velipoje)
 Zone natyrore të manaxhuara (Shëngjin)
 Zone të resurseve të manaxhuara (Fushë Kuqe)

Zona me monumente natyrore
 Habitat/ biotope të vecanta
 Shpella karstike

Zona me rëndesi të vecante mjedisore
 Rezerve të resurseve të manaxhuara (Orosh - Selite)
 Monumente natyrore

Rezultatet e kësaj analize kanë konvertuar në tri nënrajone kryesore:

1. *Nënrajoni i Bregdetit*: ky nënrajon shtrihet në njësitë vendore të Shëngjinit, Shënkollit dhe Fushë-Kuqes. Shëngjini është aktualisht destinacioni kryesor turistik në Qarkun e Lezhës. Afërsia e këtij nënrajonit me plazhin e Velipojës dhe me bregdetin përtej kufirit (me Ulqinin) e bën zonën mjaft tërheqëse për hartimin e itinerareve ndërkufitare. Megjithatë, nga ana tjetër ky nënrajon përfshin disa rezervate natyrore me rëndësi të veçantë mjedisore, ndaj zhvillimi i sektorit të turizmit duhet të bëhet në mënyrë shumë të kujdesshme dhe të ndjeshme ndaj ndikimit që ky zhvillim mund të ketë në mjedis.

Skenari i zhvillimit të turizmit në nënrajonin e Bregdetit: Karakteristikat tërheqëse të nënrajonit e bëjnë atë të përshtatshëm për zhvillimin e disa llojeve turizmi, nga ai familjar në ekoturizëm. Megjithatë, duke synuar nxitjen e zhvillimit të sektorit të turizmit duhet bërë kujdes që ky sektor të mos dëmtojë ekosistemet ekzistuese në zonat e mborjtura dhe ato buferike. Për këtë arsye, fokusi i ndërhyrjeve në këtë nënrajon duhet të jetë në:

- Mbështetjen e njësive vendore për hartimin e Instrumenteve të Planifikimit Vendor ose në harmonizimin dhe koordinimin mes dy Instrumenteve të Planifikimit Vendor (në rastin e hartimit të dy Instrumenteve të veçanta, për secilën njësi vendore të ardhshme: Lezhë dhe Kurbin), me qëllim mirëpërcaktimin e zonave të zhvillimit turistik dhe zonave ku do ndalohet zhvillimi;
- Diversifikimin e ofertës turistike përmes ndërthurjes së turizmit bregdetar me ekoturizmin;
- Mbështetjen e transportit të gjelbër (shtigje këmbësorësh/biçikletash), sidomos në zonat me ndjeshmëri mjedisore, si e vetmja mundësi aksesimi nga ana e turistëve (aty ku do jetë e mundur) dhe atë të transportit publik për pjesën tjetër të nënrajonit.
- Ngritje kapacitetesh në sektorin e turizmit.

2. *Nënrajoni i Kulturës*: përfshin pjesë nga njësitë vendore Blinisht, Kallmet, Lezhë, Kolsh, Zejmen, Milot, Laç, Rrëshen dhe Rubik. Në këtë nënrajon gjenden disa nga objektet e kultit më të rëndësishme të Qarkut Lezhë si: Kisha e Laçit, Kisha e Shën Eufemisë (Kallmet) Padre Antonio (Këmbanat e Paqes - Blinisht), si dhe objekte të tjera të kultit në Pllanë, Rubik. Krahas objekteve fetare në këtë nënrajon gjenden edhe asete të tjera me rëndësi historike si Kalaja mesjetare e Lezhës, Memoriali i Skënderbeut si dhe trashëgimia kulturore e shkruar si: "Kanuni i Lekë Dukagjinit ("Kanuni i Maleve" dhe "Kanuni i Skënderbeut").

Skenari i zhvillimit të turizmit në nënrajonin e Kulturës: Për promovimin e këtyre vlerave historike/kulturore dhe ndërthurjen e tyre me ekoturizmin, rekomandohet që zhvillimi të orientohet drejt:


- Hartimit dhe promovimit të produkteve turistike me fokus turizmin kulturor dhe fetar;
- Diversifikimit të ofertës turistike përmes ofrimit të produkteve turistike në zonën e Zadrimës, përmes bashkëpunimit ndërrajonal me Qarkun Lezhë;
- Promovimit të infrastrukturës së gjelbër përmes sinjalistikës përkatëse dhe hartimit të itinerareve (për ecje apo çiklizëm);
- Integritet të aktiviteteve turistike me ato enologjike, kryesisht në zonën e Zadrimës;
- Ngritjes së kapaciteteve të rinjve që operojnë/synojnë të operojnë në sektorin e turizmit.

3. *Nënrajoni i Natyrës*: përfshin disa sipërfaqe të njësive vendore të Oroshit, të Fanit, të Selitës dhe të Kthellës. Ky nënrajon përfshin pyjet e Oroshit, të shpallura si Rezervë e resurseve të menaxhuara si dhe një sërë atraksionesh natyrore dhe kulturore/historike si: Shpellat karstike në Kthellë dhe në Kroin e bardhë, Burgun e Spaçit, Kullat e Mirditës etj. Afërsia me Parkun e Lurës, e bën këtë nënrajon akoma më tërheqës.

Skenari i zhvillimit të turizmit në nënrajonin e Natyrës: Në mbështetje të zhvillimit të sektorit të turizmit në këtë nënrajon, ndërhyrjet duhet të fokusohen në:

- Hartimin dhe promovimin e produkteve turistike me fokus turizmin natyror, duke forcuar edhe partneritetet ndërrajonale me Qarkun Dibër;
- Promovimin e infrastrukturës së gjelbër përmes sinjalistikës përkatëse dhe hartimit të itinerareve (për ecje apo çiklizëm);

QARKU LEZHË - Nënrajonet me potenciale të ngjashme zhvillimi në sektorin e turizmit



Nënrajoni i bregdetit: Nënrajon me potencial të lartë turistik. Nderthurje e turizmit bregdetar me ekoturizmin. Fokus i nderthurjeve në manaxhimin e qendrueshëm të zonave turistike, diversifikimin e produktit turistik & marketimin e tij dhe ngritje kapacitetesh në funksion të sigurisë së turistëve

Nënrajoni i kultures: Nënrajon me potencial relativisht të lartë turistik. Nderthurje e turizmit kulturor me ekoturizmin. Fokus i nderthurjeve në diversifikimin e produktit turistik & marketimin e tij, ngritje kapacitetesh në funksion të përmirësimit të shërbimeve, restaurim asetesh historike/fetare.

Nënrajoni i natyres: Nënrajon me potencial relativisht të lartë turistik. Fokus turizem natyror dhe integrim me parkun e Lures. Fokus i nderthurjeve në diversifikimin e produktit turistik & marketimin e tij, përmirësim të sinjalistikës dhe transportit.

Nënrajonet e mjedisit

Analizat e hartuara, të dobësive, por edhe të potencialeve mjedisore të Qarkut Lezhë, kanë ndihmuar në identifikimin e dy nënrajoneve. Nënrajonet e identifikuar, në të cilat problematikat mjedisore shfaqen më emergjente për shkak të rëndësisë mjedisore dhe të brishtësisë që kanë këto zona janë:

1. *Nënrajoni Shëngjin-Shënkoll-Fushë-Kuqe*: Ky nënrajon përfshin zona me rëndësi të veçantë mjedisore si: Kompleksi Kune-Vain dhe kompleksi ligatinor i Patokut. Laguna e Kune Vainit është e vendosur në mes të bregdetit shqiptar të Adriatikut, në të dy anët e grykëderdhjes së lumit Drin i Lezhës, 70 km larg nga kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana. Kjo zonë është e para Zonë e Mbrojtur e Shqipërisë, e shpallur si Rezervë Gjuetie që nga viti 1940, dhe e dekretuar dhe e ridekretuar si Rezervë Gjuetie dhe Rezervë e Menaxhuar 4 herë. Zyrtarisht, sipërfaqja e Zonës së Mbrojtur është 2,300 ha. Nga vitet 1990 deri në ditët tona shumë projekte dhe plane kanë propozuar që ta zgjerojnë këtë sipërfaqe, për sa kohë ky zgjerim është i dobishëm për qëllime konservimi dhe për përdorimet afatgjata të resurseve të zonës nga komuniteti. Ndërsa kompleksi Ligatinor i Patokut përfaqëson një nga bukuritë natyrore me interesante të bregdetit Adriatik. Ky kompleks përfshin një llojshmëri të lartë habitatesh: laguna e brendshme dhe e jashtme (480 ha), pylli (200 ha), tokat bujqësore (450 ha) dhe blegtorale (150 ha). Kjo është ajo çfarë ka mbetur nga një zone e mëparshme prej 4200 ha që ka kaluar një proces interesant zhvillimi, për shkak të faktorëve natyrorë dhe të aktiviteteve njerëzore. Me gjithë biodiversitetin e pasur që kanë këto zona, ato janë vazhdimisht në rrezik dëmtimi si rezultat i veprimtarive natyrore dhe artificiale (nga njeriu).

Skenari i zhvillimit të qëndrueshëm i nënrajonit Shëngjin-Shënkoll-Fushë-Kuqe: Për të zvogëluar impaktin mjedisor të ndryshimeve klimatike dhe të aktiviteteve njerëzore, është e rëndësishme që ndërhyrjet të fokusohen kryesisht në:



- Përqendrimin e investimeve në mbrojtjen e deltave të lumenjve Drin dhe Mat, siç parashikohet nga studimi "Identifikimi dhe zbatimi i masave për përshtatje në deltat e lumenjve Drin dhe Mat";
- Uljen e impaktit mjedisor si rezultat i mbetjeve të ngurta dhe i ujërave të ndotura të prodhuara në këtë zonë;
- Studime fizibiliteti për gjithë zonën në kuadër të mbrojtjes nga ndikimet negative si rezultat i ndryshimeve klimatike.

2. *Nënrajoni Orosh- Fan- Selitë*: Edhe ky nënrajon përfshin zona me rëndësi të veçantë mjedisore si Parku i Oroshit (Bjeshka e Oroshit) e shpallur zonë e mbrojtur e kategorisë IV në vitin 1996, me një sipërfaqe totale prej 4700 ha. Kjo zonë përbën sipërfaqen pyjore më tërheqëse në Qarkun e Lezhës, për mbrojtjen e së cilës duhen marrë masat e nevojshme.

Skenari i zhvillimit të qëndrueshëm i nënrajonit Orosh- Fan- Selitë: Me qëllim mbrojtjen e këtyre zonave dhe promovimin të këtij nënrajonit si një nënrajon i gjelbër – në funksion edhe të marketimit të tij si një zonë tërheqëse për ekoturizëm ndërhyrjet duhet të fokusohen në:

- Ruajtjen e integritetit territorial dhe të biodiversitetit të zonave të mbrojtura brenda këtij nënrajonit;
- Mbështetjen e energjive të gjelbra në rajon, me qëllim promovimin e nënrajonit si një nënrajon me ndjeshmëri të lartë ndaj mjedisit.

Harta 10. Nënrajone me vlera të ngjashme ose probleme të ngjashme në fushën e mjedisit (© Co-Plan)



Nënrajoni Shengjin-Shenkoll-Fushe Kuqe:
 Nënrajon me vlera mjedisore te konsiderueshme (siperfaqe dhe monumente te mbrojtura)
 Fokusi i nderhyrjeve: parandalimi i erozionit bregdetar, mbrojtja nga ndotja dhe balancim i aktiviteteve turistike me qendrueshmerine mjedisore

Nënrajoni Orosh-Fan-Selite:
 Nënrajon me vlera mjedisore te konsiderueshme (siperfaqe dhe monumente te mbrojtura)
 Fokusi i nderhyrjeve: sigurimi i integritetit territorial dhe biodiversitetit te siperfaqeve pyjore

Industri

Duke konsideruar variablat e marrë në shqyrtim për këtë sektor, janë identifikuar nënrajonet e mëposhtme:

1. *Nënrajonin i Mirditës:* Me një nëntokë mjaft të pasur me burime minerare, sidomos të njohur për burimet e bakrit. Industria e përpunimit të bakrit ka qenë një ndër sektorët që ka ofruar mundësi të mëdha të punësimit në këtë nënrajon. Pas viteve '90, shumë objekte të rëndësishme të metalurgjisë shkrirëse u braktisën dhe për pasojë filluan të degradojnë duke krijuar risqe të konsiderueshme mjedisore.



Skenari i zhvillimit për nënrajonin e Mirditës: Ndërhyrjet në këtë nënrajon do të synojnë zvogëlimin e ndikimit negativ mjedisor që kanë ish-zonat industriale në rajon, shmangien e kontaminimit të ujërave nëntokësore nga veprimtaritë industriale në zonë, si dhe trajtimin e mbetjeve minerale. Natyrisht, përpjekjet e Qarkut në vijim do të kenë për fokus harmonizimin e politikave qendrore (kryesisht për këtë nënrajon), me ato vendore.

2. *Nënrajonin i Shëngjinit:* Ky nënrajon është identifikuar në këtë studim për dy arsye: prezencën e portit dhe prezencën e disa industrive të përpunimit të peshkut në afërsi të tij. Këto të fundit, vuajnë për lëndën e parë vendase, ndaj në shumicën e rasteve ajo importohet nga Kroacia. Mungesa e flotave të përhershme të peshkimit, ka bërë që ky sektor industrial të mos mbështetet në lëndën e parë vendase, e cila gjendet në sasi të konsiderueshme në brigjet e detit Adriatik. Ky potencial i pashfrytëzuar ekonomik, e bën nënrajonin tërheqës në këtë aspekt.

Skenari i zhvillimit për nënrajonin e Shëngjinit: Ndërhyrjet e propozuara do të përqendrohen në funksion të mbështetjes së industrisë së peshkut. Nevojat e këtij sektori duhen hulumtuar më me imtësi, dhe duhen marrë masa konkrete për mbështetjen e zinxhirit përpunues të peshkut, në funksion të nxitjes së zhvillimit ekonomik të këtij nënrajonit.

Harta 11. Nënrajone me problematika dhe potenciale të ngjashme zhvillimi në sektorin industrial (© Co-Plan).

QARKU LEZHË - Nënrajonet industriale



c. Përgatitja e Projekteve Pilote dhe e Planit të Veprimit

- Metodologjia e përdorur për përzgjedhjen e projekt-propozimeve

Përzgjedhja e projekt – propozimeve është paraprirë nga një vlerësim dhe konsultim paraprak i të gjithë dokumenteve strategjike në nivel rajonal përmes një procesi gjithëpërfshirës. Identifikimi i projekt-propozimeve është mundur përmes sjelljes së bashku të aktorëve lokalë, rajonalë dhe qendrorë, duke kontribuar jo vetëm në harmonizimin e prioriteteve sektoriale, por edhe në lidhjen e tyre me prioritetet në nivel rajonal dhe qendror. Identifikimi dhe harmonizimi i projekt-propozimeve është realizuar përmes punës

në grupe gjatë workshop-eve rajonale (4 workshop-e rajonale) dhe takimeve konsultative me drejtues dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore në Qark dhe Organizata të Shoqërisë Civile. Përgjatë këtyre takimeve dhe punës në grupe gjatë workshop-eve rajonale janë konsultuar prioritetet sipas sektorëve dhe fushave prioritare të Qarkut (bujqësi, pylltari dhe peshkim; turizëm, mjedis, energji dhe industri) të cilat janë vlerësuar duke marrë parasysh potencialet rajonale dhe duke vlerësuar kontributin e tyre në zhvillimin social – ekonomik të nënrajoneve të identifikuar për secilin sektor. Kuadri Strategjik i Qarkut i konsultuar përfshin dokumenta si: Plani i Menaxhimit të Basenit të Lumit Mat; Plani i Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur të Kune Vainit; Programi për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit në Lezhë 2013-2015; Identifikimi dhe Implementimi i Masave Adaptuese për Deltat e lumit Drin e Mat; Strategjia e Turizmit dhe e Agroturizmit në Rajonin e Lezhës; Plani Rajonal për Menaxhimin e Pyjeve dhe të Kullotave në Qarkun Lezhë si dhe dokumentet Strategjike të Njësive të Qeverisjes Vendore në Qarkun Lezhë. Në këtë kuadër, janë zhvilluar tryeza diskutimi me përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, në Agjencitë e Ujit dhe të Baseneve, në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimin dhe Shërbimit Social si dhe me drejtues të Drejtorisë së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe Ekspertë Ndërkombëtarë/Kombëtarë në fushën e Turizmit. Ky proces i gjerë konsultimi ka orientuar identifikimin e projekteve konkrete me impakt zhvillimin sektorial e rajonal dhe njëherësh ka mundësuar vlerësimin e secilit projekt-propozim në raport me objektivat strategjike rajonale për sektorët konkretë (bujqësi, turizëm, mjedis dhe industri) brenda kuadrit të stimulimit të nënrajoneve ku ato parashikohen të implementohen. Në aspektin strategjik projektet janë vlerësuar në raport me Masat në Konceptin e Zhvillimit Rajonal dhe Nënrajonin ku projekti do të mund të implementohet duke siguruar lidhjen e objektivave strategjike rajonale me ndërhyrjet e parashikuara në Planin e Veprimit. Në funksion të identifikimit të projekteve si pjesë e Planit të Veprimit përzgjedhja e tyre bazohet në modelin e prioritarizimit, proces, i cili është udhëhequr nga disa kriterë vlerësimi dhe konkretisht:

Kontributi i projektit në masat e Konceptit Strategjik të Zhvillimit Rajonal (lidhja e tij me Masat dhe Nënrajonin) dhe dokumentet e tjera strategjike, të cilat adresojnë çështje zhvillimore në Qarkun Lezhë;

- Mobilizimi i potencialeve të zhvillimit në nënrajonin ku do të zbatohet projekti;
- Impakti rajonal dhe nënrajonal/rajonal;
- Projekti zhvillohet në më shumë se një NjQV;

- Projekti mbështet sektorin prioritar të evidentuar në nënrajon;
- Projekti ka efekt zinxhir në sektorë të tjerë dhe në zhvillimin ekonomik nënrajonal dhe rajonal (potenciali ekonomik);
- Projekti stimulon sektorin privat në iniciativa të ngjashme;
- Projekti adreson prioritetet strategjike të dokumenteve strategjike (KZHR, PS e Turizmit, PRM e Pyjeve dhe të Kullotave, PRM në zonat e mbrojtura etj);
- Projekti adreson një emergjencë në rajon;
- Projekti adreson zgjidhjen e problemeve sociale dhe kontribuon në përfshirjen sociale;
- Projekti nxit mjedis të qëndrueshëm sipas objektivave të shprehur në Planin Rajonal të Veprimit në Mjedis;

Bazuar në kriteret më sipër, janë identifikuar 96 projekte konkrete, të cilat kanë ardhur si pjesë e tryezave të diskutimeve me partnerë lokalë, rajonalë e kombëtarë dhe si pjesë e punës në grupe gjatë workshop-eve rajonale. Përtej kriterëve të mësipërme, identifikimi i projekteve, pjesë e Planit të Veprimit, u parapri nga një tjetër etapë vlerësimi (workshop-i 3 rajonal) me pikë, duke konsideruar secilin prej projekteve dhe iniciativave të identifikuar në raport me dy aspekte themelore: “niveli strategjik” dhe “mundësitë e financimit” pa humbur fokusin nga marrëdhënia e projekteve me: (a) Masën në Konceptin e Zhvillimit Rajonal dhe (b) kontributin në nënrajonin ku bën pjesë. Në përfundim të këtij procesi identifikimi, konsultimi, vlerësimi dhe prioritarizimi, Plani Veprimit të Konceptit të Zhvillimit Rajonal të Qarkut Lezhë përfshin 35 projekte prioritare, të cilat sipas sektorëve kontribuojnë si më poshtë:

Në sektorin Bujqësi, pylltari dhe peshkim janë identifikuar 11 projekte (31% e totalit) të cilat mbështesin 4 Masat e Qëllimit Strategjik për këtë Fushë Prioritare.

Në sektorin e Turizmit janë identifikuar 13 projekte (ose 36% e totalit) të cilat mbështesin 5 Masa dhe 2 fusha prioritare me fokus zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori dhe rritjen e aksesit të turistëve.

Në sektorin e Mjedisit janë identifikuar 7 projekte (ose 19% e totalit), të cilat mbështesin 2 Masa me fokus krijimin e një mjedisi të sigurtë dhe atraktiv.

Në sektorin e industrisë janë identifikuar 5 projekte (ose 14% e totalit) të cilat mbështesin 1 Masë brenda fushës prioritare respektive.

Nga vetë shpërndarja e projekteve midis sektorëve, projektet e Planit të Veprimit synojnë stimulimin e secilit sektor duke ruajtur fokus në sektorët tipikë të zonës: bujqësi, pylltari dhe peshkim dhe turizëm, pa humbur fokusin në sektorë si mjedisi dhe industria.

- Matrica përfundimtare e projekt propozimeve

Në sektorin e Bujqësisë, matrica e projekt propozimeve dhe lidhja e tyre me nën-rajonet për këtë sektor është si më poshtë:

Fushat Prioritare	Qëllimi Strategjik	Masat	Nënrajoni i Zadrimës
			Dajç
			Blinisht
			Kallmet
			Balldren
			Ungrej
Bujqësi, pylltari dhe peshkim	Zhvillimi i mëtejshëm i bujqësisë dhe agrobiznesit të lidhur në një rrjet me kapacitete të larta industriale	5.1.1. Mbështetje e koordinuar për bizneset e vogla bujqësore, blegtorale dhe akuakulturën	1. Fuqizimi i sektorit të prodhimit dhe përpunimit të ullinjve, përmes zgjerimit me 1000 ha ullishte në Paçram-Hajmel-Bushat-Bërdicë_ Kallmet-Dajç
			2-Mbështetje e ngritjes së një qendre grumbullimi dhe përpunimi për produktet e gështenjës dhe arrës në Ungrej
			6- Mbështetje e produkteve të ullirit dhe sheges në Balldren dhe Kallmet
		5.1.2. Marka rajonale	
		5.1.3. Edukimi në bujqësi, pylltari dhe peshkim	
5.1.4. Infrastruktura Bujqësore			

BUJQËSIA	
Nënrajoni i Lezhë-Kurbinit	Nënrajoni i Rubik - Rrëshen
Zejmen	Rrëshen
Milot	Rubik
Laç	Kthellë
Mamurras	
Fushë Kuqe	
Shënkoll	
Shëngjin	
Kolsh	
Lezhë	
3-Zgjerimi i tregjeve për produktet vendase përmes ndërtimit të marketit sezonal në Shëngjin	5-Fuqizimi i sektorit të vitikulturës dhe enologjisë përmes mbështetjes së prodhimit vendas dhe markave rajonale (Arbri_ Bukmirë/ Rrëshen) dhe në Kallmet
4- Mbështetje e agrobujqësisë (zgjerimi i të mbjellave me zarzavate) në zonën Zejmen-Shënkoll-Fushë Kuqe me fokus ndërmjetësimin mes fermerëve të zonës dhe fabrikës përpunuese në Pllanë	
7- Mbështetja e industrisë së përpunimit të peshkut përmes lehtësimit të ngritjes së flotave të peshkimit të përherëshme dhe ndërmjetësimin mes tyre dhe pikave të përpunimit të peshkut	
8- Festivali Gastronomisë Ambulant për promovimin e markave vendase në Dajç, Shëngjin dhe Rrëshen si pjesë e festivalit të Zadrimës (Kallmeti, Arbri, Kosi Dudi, Fazanat e Fushë Kuqes, Gjeli Dedit, Keci, Djathi etj)	
9- Informim, trajnim dhe asistencë për fermerët në lidhje me mundësitë për financim në kuadër të zhvillimit rural (identifikimin e target grupeve- ngritja e grupeve lokale te veprimit).	
10- Studimi nevojave dhe identifikimi investimeve për ndërtimin e Dhomave Frigoriferike dhe Qendrave Magazinuese të produkteve bujqësore dhe blegtorale në rajonin e Lezhës me qendër në Zadrimë, Milot dhe Rrëshen	
11- Koordinim me Bordin e Kullimit dhe Drejtorinë e Bujqësisë në realizimin e projekteve konkrete në drejtim të rehabilitimit të sistemit kullues dhe ujitës dhe eliminimin e përmytjeve. Mbështetje për hartimin e planit të veprimit në këtë drejtim	

Në sektorin e Turizmit, Matrica e projekteve të përzgjedhura dhe lidhja e tyre me Masat dhe Nënrajonet në Qarkun Lezhë është si më poshtë:

Fushat Prioritare	Qëllimi Strategjik	Masat	Nënrajoni i Natyrës
			Orosh
			Fan
			Selitë
5. Menaxhimi rajonal, konteksti i partneriteteve brenda dhe ndër-rajonale & qeverisja e orientuar drejt qytetarit	Konsolidimi dhe mbështetja e raporteve dhe marrëdhënieve pozitive dhe transparente midis komuniteteve në nivel rajonal	5.5.1. Bashkëpunimi me Njësitë e Qeverisjes Vendore në territorin e Qarkut, si edhe vetë Këshilli i Qarkut do t'i japin përparësi përfaqesjes së tyre ndaj një qeverisje të orientuar drejt qytetarit	
5.6. Sektori turizmit, promotor i zhvillimit ekonomik vendor dhe rajonal përmes promovimit të trashëgimisë kulturore, produkteve turistike dhe konsolidimit të shërbimeve turistike nënrajon	Qarku Lezhë, potencial turistik në fushën e turizmit bregdetar, malor, familjar dhe artizanal në rajon.	5.6.1. Zhvillimi dhe diversifikimi i produkteve turistike duke u mbështetur në vlerat e trashëgimisë kulturore/historike, natyrore dhe fetare	13- Krijimi dhe promovimi i një produkti turistik duke përfshirë atraksionet turistike në Njësitë Vendore Fan, Orosh, Selitë dhe Kthellë dhe Njësitë Vendore që përfshijnë Parkun e Lurës (Shpellat karstike të Kthellës dhe Kroin e Bardhë, Burgu i Spaçit, Parkun e Oroshit, Lurë, Kullat e Mirditës)
		5.6.2 Promovimi i imazhit turistik të Qarkut Lezhë	
		5.6.3 Restaurimi dhe mirëmbajtja e aseteve turistike	
		5.6.4. Lehtësimi i vizitimit të Qarkut Lezhë nga turistët përmes përmirësimit të infrastrukturës turistike dhe rritjes së kapaciteteve humane.	19- Ndërtimi rrethit të infrastrukturës dhe sinjalistikës turistike në nënrajonin Orosh-Fan-Selitë (Kthellë-Selitë) që i shërbejnë eksplorimit të Shpellave Karstike dhe Kroin e Bardhë

Turizmi	
Nënrajoni i Bregdetit	Nënrajoni i Kulturës
Shëngjin	Blinisht
Shënkoll	Kallmet
Fushë Kuqe	Rubik & Rrëshen
	Zejmen
	Lezhë
	Kolsh
	Milot
	Laç
12- Mbështetje dhe koordinim për hartimin e Instrumenteve të Planifikimit të Territorit për Njësitë Vendore Shëngjin, Shënkoll dhe Fushë Kuqe, me fokus zhvillimin e turizmit dhe mbrojtjen e natyrës	
14- Krijimi dhe promovimi i një produkti turistik duke përfshirë atraksionet turistike në NjQV-të Shëngjin, Shënkoll dhe Fushë Kuqe	15- Krijimi i një produkti turistik me fokus turizmin historik dhe fetar, duke përfshirë (Kisha e Laçit, Destinacionet në Bashkinë e Lezhës, Kisha e Shën Eufemisë/Kallmet), Padre Antonio (Kambanat e Paqes - Blinisht), Pllanë, Rubik, Orosh)
	16- Promovimi i festivalit Zadrima ne Fishtë
17- Krijimi i një platforme dixhitale për promovimin e destinacioneve turistike në Qarkun Lezhë (Strategjia e Turizmit e Qarkut Lezhë)	
	18- Restaurimi i Kishës Shën Barbara (Pllan) dhe Shën e Premte (Balldre)
	20- Projektimi i një itinerari çiklistik përgjatë Drinit të vjetër, duke lidhur Zadrimën - Lezhë - Shëngjin (vazhdim i itinerarit të biçikletave/ projekti Dajçit B.Bunës "Living the river")
21- Koordinim dhe mbështetje në hartimin e një Plani Transporti Publik Rajonal, me prioritet zonat turistike	
	22- Identifikimi i shtigjeve, hartimi i hartave dhe i sinjalistikës përkatëse - <i>trekking tourism</i>
	23- Hapja e një shkolle të mesme profesionale me fokus Hoteleri/ Turizëm dhe kurseve profesionale në mbështetje të këtij sektori (Mbështetja e arsimit profesional në fushën e Hoteleri - Turizmit)
24- Trajnim i guidave turistike dhe stafit të sigurisë bregdetare në bashkëpunim me Shkollën e Mesme Profesionale të Hoteleri/Turizëm	

Në sektorin e Mjedisit, Matrica e projekteve të përzgjedhura dhe lidhja e tyre me Masat dhe Nën-Rajonet është si më poshtë:

Fushat Prioritare	Qëllimi Strategjik	Masat
5.4. Mjedis dhe Energjia	Përmirësimi i infrastrukturës mjedisore dhe shërbimeve të lidhura me mjedisin si një parakusht për përmirësimin e mundësive social-ekonomike dhe si një faktor nxitës për koordinimin me sektorët e tjerë, si atë energjetik	5.4.2. Planifikimi dhe zbatimi infrastrukturës mjedisore
		5.4.3. Projekte energjetike për të ardhmen

Mjedisi		
	Nënrajoni Orosh – Fan – Selitë	Nënrajoni Shëngjin-Shënkoll-Fushë- Kuqe
	Orosh	Shëngjin
	Fan	Shënkoll
	Selitë	Fushë Kuqe
	Rrëshen	Mamurras
	Rubik	
	25- Sigurimi i integritetit territorial dhe biodiversitetit të sipërfaqeve pyjore dhe zgjerim i sipërfaqes së mbjellë - Orosh, Mirditë	26- Konsolidim i rrjetit KUZ në NjQV-të Shënkoll & Zejmen (me fokus zgjerimin dhe përfshirjen e NjQV-ve Shëngjin dhe Fushë Kuqe) dhe lidhja e këtij rrjeti me Impiante të Trajtimit të Ujërave të Zeza
		27- Menaxhimi erozionit bregdetar- një parakusht për mbrojtjen nga ndryshimet klimaterike (UNDP)
	28- Mbështetje njësisve vendore në zbatimin e Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Hartuar me mbështetjen e SELEA në vitin 2013) dhe koordinimi i zbatimit të tij	
	29- Identifikimi, Studimi Fizibilitetit dhe Plani Veprimi për parandalimin e erozionit në zonat e prekura të Qakut Lezhë	
		30- Përgatitja e Studimit të Fizibilitetit për të gjithë zonën e Deltës së lumit Drin-Mat në kuadrin e mbrojtjes nga ndryshimet klimatike (UNDP)
	31- Studim Fizibiliteti dhe promovimi i përdorimit të energjisë së rinovueshme (diellore) në njësitë e akomodimit (guesthouses) në Orosh, Fan, Selitë	

Në sektorin e Industrisë, Matrica e projekteve të përzgjedhura dhe lidhja e tyre me Masat dhe Nën-Rajonet është si më poshtë:


Fushat Prioritare	Qëllimi Strategjik	Masat	Industria	
			Nënrajoni i Mirditës	Nënrajoni i Shëngjinit
			Ungrej	Shëngjin
			Kaçinar	
			Rrëshen	
			Kthellë	
			Selitë	
			Fan	
			Rubik	
			Gjegjan	
3. Zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura	Zhvillimi i sektorit privat përmes organizimit dhe bashkëpunimit të bizneseve, si dhe koordinimit të faktorëve të ndryshëm nxitës në nivel rajonal dhe kombëtar	5.3.1. Përcaktimi i zonave të biznesit dhe infrastrukturës përkatëse	32- Rehabilitimi zonave të dampave minerare në Orosh, Selitë, Rrëshen dhe Kaçinar	
			33- Hartimi një strategjie për ruajtjen e ujërave nëntokësore nga ndotjet (infiltrimi i ujit) në zonat e kontaminuara nga veprimtaritë industriale_ Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	
			35- Hartimi një Plani Veprimi për ndërhyrje në zonat kafe në rajon, promovimi dhe vendosja e tyre në funksion të stimulimit të investitorëve dhe donatorëve të huaj në bashkëpunim me Ministrinë.	34- Ndërtimi punishtës së riparimit të anijeve të flotës së peshkimit
			36- Identifikimi, Studimi Fizibilitetit dhe Plani Veprimit për trajtimin e mbetjeve inerte nga aktiviteti industrial përgjatë lumenjve	

Projektet propozimet e përzgjedhura si pjesë e Planit të Veprimit, të interpretuara së bashku me projekte të tjera që po zbatohen në Qarkun Lezhë dhe me potencialet ekonomike ekzistuese në nënrajonet e specifikuar, i shpërbejnë zbatimin të një skenari zhvillimi ekonomik nënrajonal të përcaktuar që më herët gjatë analizave të potencialeve ekzistuese ekonomike në nivel nënrajoni. Në hartën e mëposhtme janë treguar skematikisht disa nga projektet e propozuara si pjesë e Planit të Veprimit për nënrajonin e Shëngjin-Shënkoll-Fushë Kuqe dhe zonat e ndikimit. Po ashtu, në këtë skemë janë treguar edhe disa projekte të cilat po zbatohen në kuadër të fondit të RDP-së, përmes dritareve 1, 2 dhe 3. Kjo skemë është ilustruese, dhe nuk paraqet të gjithë projekt propozimet e përzgjedhura për nënrajonin në fjalë, megjithatë jep një ide të përgjithshme se si projektet e përzgjedhura i shërbejnë të njëjtit skenar zhvillimi ekonomik të nënrajonit.

Nënrajoni i përzgjedhur, për nga natyra është mjaft delikat, duke marrë parasysh që përfshin në vetvete zona me vlera të veçanta natyrore dhe mjaft vulnerabël ndaj aktiviteteve njerëzore. Ndaj propozimet në sektorin e bujqësisë dhe turizmit, janë shumë të ndërlidhura me propozimet mjedisore. Në këtë kuadër, projekti më kyç dhe i domosdoshëm është Përgatitja e Studimit të Fizibilitetit për të gjithë zonën e Deltës së lumit Drin-Mat në kuadrin e mbrojtjes nga ndryshimet klimatike, që do të shërbejë si bazë për ndërhyrjet substanciale me karakter mbrojtjen e mjedisit në këtë nënrajon. Një ndërhyrje tjetër e propozuar

ka lidhje me menaxhimin e erozionit në zonat bregdetare të mbrojtura, që vjen si propozim nga paketa e projekteve për zbutjen e ndikimit në mjedis të ndryshimeve klimatike. Ndërhyrjet e tjera të propozuara synojnë zbutjen e ndikimit negativ në mjedis nga aktivitetet ekonomike/bujqësore si konsolidimi i rrjetit KUZ (në vijimësi të projektit të financuar nga RDPF W1 në Bashkinë e Mamurrasit), mbështetje e njësisë vendore për zbatimin e Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbjetjeve, etj. Natyrisht masat dhe projektet për mbrojtjen e mjedisit, kanë prioritet në zona në të cilat asetet natyrore janë me interes të veçantë kombëtar, si dhe në zona ku qëndrueshmëria mjedisore ndërlidhet me qëndrueshmërinë në sektorë të tjerë. Prandaj rehabilitimi i infrastrukturës bujqësore (kullimit dhe ujitjes) mbetet prioritar për të dy sektorët (bujqësinë dhe mjedisin). Meqenëse ky nuk është funksion i drejtpërdrejtë i qarkut, projektet e kësaj natyre janë konceptuar si asistencë që i jep qarku institucioneve përgjegjëse për aksesimin e mundësive të financimit, përtej buxhetit të shtetit, për të tilla projekte mjaft kyçe në sektorin e bujqësisë. Ndërhyrjet e tjera të propozuara në sektorin e bujqësisë fokusohen në nevojën për promovimin e produkteve tipike të zonës përmes: nxitjes së sektorit të peshkimit përmes krijimit të flotave të përhershme dhe punishtes për riparimin e tyre, si dhe rritja e partneriteteve mes fermerëve dhe sipërmarrësve në industrinë ushqimore. Po ashtu, në kuadër të zgjerimit të tregut për produktet bujqësore, si dhe mbështetjes së sektorit të turizmit me sektorin agro-bujqësor, propozohet edhe ngritja e një marketi sezonal në Shëngjin. Sektori bujqësor dhe mjedisor ndërthurur me potencialet eko-turistike që ka nënrajonin, nënvijëzojnë identitetin e veçantë të tij. Në kuadër të mbështetjes së zhvillimit të ekoturizmit, projektet e propozuara fokusohen në krijimi dhe promovimin e një produkti turistik duke përfshirë atraksionet turistike të Shëngjinit, Shënkollit dhe Fushë Kuqes, ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore të përfshira në këtë sektor, krijimi i një platforme dixhitale për promovimin e destinacioneve turistike (në vijim të projektit të financuar nga RDPF W2 në Shëngjin), mbështetjen dhe koordinimin për hartimin e Instrumenteve të Planifikimit të Territorit për Njësitë Vendore të sipërpërmendura, si dhe koordinimin dhe mbështetjen në hartimin e një Plani Transporti Publik Rajonal, me prioritet zonat turistike. Ndërthurja e projekteve me potencialet ekzistuese dhe projekte të tjera, siguron jetëgjatësinë e projekteve të veçanta dhe rrit ndikimin/jehonën e tyre në nënrajon, duke u kthyer kështu në projekte zhvillimore rajonale.

QARKU LEZHË - Skeme konceptuale që tregon ndërlidhjen e projekt propozimeve të Planit të Veprimit me projekte që po zbatohen në terren, në funksion të skenarit të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të nënrajonit (Shembulli I mëposhtëm tregon nënrajonin e Shëngjin-Shënkoll - Fushë Kuqe dhe zonave përreth)



- Modeli fishës së projekteve

Titulli Projektit: "Fuqizimi i sektorit të vitikulturës dhe enologjisë përmes mbështjtes së prodhimit vendas dhe markave rajonale (Arbri_Bukmirë/Rrëshen) (RË2) dhe Kallmetit"

Agjencia zbatuese:
Njësitë Vendore: Fan, Orosh, Selitë, Kthellë

Periudha e zbatimit të projektit:
1 Janar 2016 – 31 Dhjetor 2017
(24 muaj)

Kosto e projektit: 100,000 Euro
Partner: LERDA, PPP, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Vendndodhja e Projektit:
Rrëshen dhe Kallmet



Aktivitetet kryesore:

- Takime me prodhuesit lidhur me regjistrimin e markave dhe marrjen e certifikatave (ISO etj.)
- Studimi, përzgjedhja dhe kultivimi i fidanëve më afër varietetit autokton
- Krijimi i një seti promovues ku përfshihen flyers, broshura (të punuara nga enologë)
- Diskutimi i prodhimit të logovo identifikuese dhe magazinimeve të përafërta dhe identifikuese me territorin
- Evidentimi i panairëve dhe eventeve ku mund të promovohen produktet lokale
- Takime degustation me shitësit përfundimtarë (enologë, restorante, hotele)

Rezultatet e pritshme:

- Unifikimi (përafrimi) i identifikimit të markave rajonale të fidanëve më afër varietetit autokton
- Krijimi i një rrjeti unik promovimi dhe njohja e markës zyrtarisht
- Marrja e certifikatave dhe rritja e rrejtit të shpërndarjes (futja në treg më të zgjeruar)


Lidhja e Projektit me Masën në Konceptin e Zhvillimit Rajonal: Projekti kontribuon në Masën 5.1.1 me Qëllim Strategjik: "Zhvillimi i mëtejshëm i bujqësisë dhe agrobiznesit të lidhur në një rrjet me kapacitete të larta industriale" të Fushës Prioritare "Bujqësi, Pylltari dhe Peshkim"

Përfituesit: Fermerët në zonën e Rrëshenit dhe Kallmetit dhe Sektori vreshtarisë dhe enologjisë në Rajon

- Plani Veprimit dhe mundësitë e financimit


Realizimi projekteve të parashikuara në Planin e Veprimit shkon në funksion të nivelit të realizimit të buxhetit të Këshillit të Qarkut, buxhet i cili, në tërësinë e vet dominohet nga transfertat qeveritare. Në këtë kontekst, parashikimet buxhetore konsiderojnë strukturën administrative të Këshillit të Qarkut si dhe kuadrin ligjor për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë (ligjin 9936/2008; Udhëzimin nr. 2/2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; ligjin 9632/2006 ndryshuar me ligjin 181/2013) si dhe strukturën funksionale të Qarkut konform ligjit 8652/2000. Në vlerësimin e treguesve buxhetorë, parashikimet afatmesme mbështeten në të ardhurat nga (a) transfertat qeveritare; (b) të ardhurat jotatimore (aktiviteti ekonomik i Këshillit të Qarkut); (c) dhuratat dhe sponsorizimet (d) financimet e projekteve të ndryshme; (e) taksa dhe tatime të aplikuara në nivel Qarku (8652/2000 neni 18 pika 1 dhe 2) për lejet e ndërtimit, tarifat e shërbimeve, lejet dhe liçencat në fushën e transportit dhe (f) gjobot. Duke vlerësuar volumin e të ardhurave në buxhetin e Këshillit të Qarkut, rezulton se në periudhën 2015-2017 edhe pse pritshmëritë në financimin e projekteve parashikohen të zënë mesatarisht 27% të strukturës buxhetore të Qarkut, ende ky nivel të ardhurash nuk arrin të mbulojë mjaftueshëm projektet e parashikuara në Planin e Veprimit të Qarkut Lezhë. Duke shkuar më tej në strukturën buxhetore, rezulton se të ardhurat nga aktiviteti ekonomik i Qarkut (të ardhurat jotatimore dhe të trashëguara) përbëjnë mesatarisht 11% të buxhetit vjetor, ndërkohë që 27% parashikohen financimet e projekteve dhe mesatarisht 61% nga transfertat qeveritare.

Grafiku 2 Buxheti sipas burimit të të ardhurave (%-je)




Në strukturën e të ardhurave të veta të Këshillit të Qarkut, janë konsideruar të ardhurat nga aktiviteti ekonomik i Këshillit të Qarkut si dhe të ardhurat nga kuotat e Njësive të Qeverisjes Vendore (Udhëzimi nr. 3/2014 pika 47). Në këtë vlerësim, ndonëse të ardhurat e veta të Këshillit të Qarkut në periudhën 2013 – 2014 evidentojnë vlerat maksimale në raport me buxhetin duhet theksuar fakti i prezencës së të ardhurave të trashëguara në volumin e të ardhurave të veta të Këshillit të Qarkut Lezhë, burim i cili nuk mund të evidentohet përgjatë vitit ushtrimor. Në tendencën e të ardhurave të veta (veprimtaritë ekonomike dhe kuotat e Njësive të Qeverisjes Vendore) në periudhën afatmesme të parashikuar edhe nga Programi Buxhetor Afatmesëm, vihet re një trend mesatar rritës me 5%, por ende ky burim të ardhurash nuk mund të mbushë diferencën midis kërkesës për financimin e projekteve të Planit të Veprimit dhe mundësive për financim përmes buxhetit të Këshillit të Qarkut. Një tjetër dinamikë e konstatuar është edhe ruajtja e pozitës që ka transfertat e pakushtëzuar, në raport me strukturën buxhetore të Këshillit të Qarkut e cila edhe në periudhën afatmesme 2015-2017 do të vazhdojë të dominojë këtë strukturë në masën 60-61% të saj, por me një tendencë rritjeje mesatare prej 1.4% çdo vit (Udhëzimi 7/1 datë 28.02.2014). Në terma financiare, tendenca e treguesve të buxhetit në periudhën 2015-2017 vlerësohet duke konsideruar edhe treguesit e periudhës 2013-2014 si dhe duke konsideruar të gjithë kuadrin e të ardhurave rast pas rasti në uniform me përcaktimet ligjore. Konkretisht, treguesi buxhetit të Këshillit të Qarkut Lezhë, pavarësisht burimit të të ardhurave paraqitet si më poshtë:

Grafiku 3 Tregues të lidhur me buxhetin 2013-2017 (në 000/lek)




Në aspektin e shpenzimeve, shpërndarja e buxhetit sipas strukturës së shpenzimeve shkon në financimin e dy funksioneve kryesore të vet Qarkut: administrata e përgjithshme dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale. Referuar treguesve financiarë, parashikimet buxhetore mbështesin me shpenzime në masën 76% administratën e Këshillit të Qarkut dhe në masën 24% Ndërmarrjen Rajonale të Rrugëve Rurale sipas grafikut më poshtë:

Grafiku 4 Raporti Shpenzimeve sipas Funksioneve



Mbështetur në parashikimet buxhetore afatmesme, rezulton se në periudhën e parashikuar 2015-2017 buxheti i Këshillit të Qarkut Lezhë do të shkojë në masën 50% për mbulimin e fondit të pagave dhe sigurimeve (shoqërore dhe shëndetësore), shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes përbëjnë 30% të tyre, ndërkohë që shpenzimet kapitale parashikohen të zënë 20% të totalit të shpenzimeve buxhetore. Në këtë ndarje shpenzimesh janë vlerësuar edhe kërkesat e ligjit 185/2013 neni 15 ku niveli maksimal i mbulimit të shpenzimeve administrative nga transferata e pakushtëzuar është 50%. Konkretisht, raporti që zënë shpenzimet sipas artikullit në strukturën buxhetore të Këshillit të Qarkut Lezhë është si më poshtë:


Grafiku 5 Raporti shpenzimeve sipas artikullit (%-je)



Në lidhje me shpenzimet kapitale, parashikimet buxhetore mbështesin një nivel investimesh në limitet 28,500 – 30,000 lek/vit me një tendencë rritjeje nga viti në vit në masën 3%. Ky nivel shpenzimesh kapitale do të vijë si rezultat i fondeve buxhetore të cilat alokohen nga Këshilli Qarkut dhe duke synuar ndërhyrje në fusha specifike dhe si burim bashkëfinansimi në projekte konkrete në bashkëpunim me donatorë potencialë në nivel rajonal dhe ndër-rajonal me përfitim të përbashkët duke ruajtur në fokusin kryesor projektet e parashikuara në Planin e Veprimit për sektorë potencialë si bujqësia, turizmi, mjedisi dhe industria.

Referuar të dhënave mbi mundësinë e financimit të projekteve të parashikuara në Planin e Veprimit, rezulton se buxheti total i Këshillit të Qarkut për periudhën 2015-2017 do të mund të financonte vetëm 35% të kostos totale të projekteve, ndërkohë që vetëm buxheti kapital i destinuar për investime do të mund të mbulonte vetëm 7% të saj. Kjo shpërndarje e buxhetit reflekton pamundësi të financimit të projekteve (në 65% në rastin e buxhetit total dhe 93% në rastin e buxhetit kapital) përmes shpenzimeve buxhetore të vetë Këshillit të Qarkut dhe dikton nevojën për bashkëpunimin me donator dhe buxhetin qendror.

Grafiku 6 Niveli mbulimit të projekteve nga buxheti total dhe kapital



Në përfundim të vlerësimit të kapaciteteve financiare në periudhën afatmesme 2014-2017 mund të përmbledhim:

- Zbatimi i projekteve të Planit të Veprimit kërkon një koordinim dhe bashkëpunim në nivel lokal, rajonal, ndër-rajonal, kombëtar dhe me partnerë ndërkufitarë.
- Këshilli Qarkut Lezhë do të vlerësojë rast pas rasti mundësitë e pjesëmarrjes në thirrje për aplikime projektesh për fondet IPA si dhe do të vlerësojë mundësitë e bashkëfinansimit të projekteve konkrete nga skema të tjera financimi.
- Mbështetja e Planit të Veprimit përmes bashkëpunimit me aktorë të ndryshëm lokalë, rajonalë, ndër-rajonalë, kombëtarë dhe me partnerë ndërkufitarë do të mundësojë ngritjen në një shkallë më të lartë të kapaciteteve si dhe do t'i paraprijë rolit që do të mund të luajë Këshilli Qarkut përtej ndryshimeve administrative – territoriale.
- Planifikimin e shpenzimeve kapitale në funksion të bashkëfinansimit të projekteve konkrete dhe në iniciativa të përbashkëta, pjesë e Planit të Veprimit.
- Hartimin dhe përgatitjen e fishave të projekteve të propozuara në Planin e Veprimit duke identifikuar objektivat e projekteve, aktivitetet e projekteve, rezultatet e pritshme, burimin e financimit dhe periudhën në të cilën projekti do të mund të implementohet.

Në funksion të orientimit të politikave rajonale të zhvillimit, projektet e parashikuara për çdo sektor vijnë si pjesë e Planit të Veprimit 2015-2017 ku njëherësh evidentohet koha e realizimit të projektit, vlera e përafërt e projektit dhe burimet e mundshme të financimit si më poshtë:

PLANI VEPRIMIT - KËSHILLI I QARKUT LEZHË							
Nr	Projektet	Masa	Vlera	Burimi Financimit	2015	2016	2017
BUJQËSIA							
1	Fuqizimi i sektorit të prodhimit dhe përpunimit të ullinjve, përmes zgjerimit me 1000 ha ullishte në Paçram-Hajmel-Bushat-Bërdicë_Kallmet-Dajç	M.5.1.1	200,000	Buxheti Qendror, Fondet IPARD, PPP, NJQV-të			
2	Mbështetje e ngritjes së një qendre grumbullimi dhe përpunimi për produktet e gështenjës dhe arrës në Ungrej	M.5.1.1	50,000	PPP, Komuna Ungrej, Buxheti Shtetit, Donator			
3	Zgjerimi i tregjeve për produktet vendase përmes ndërtimit të marketit sezonal në Shëngjin	M.5.1.1	50,000	PPP, KQ, Komuna Shëngjin, Donator			
4	Mbështetje e agro-bujqësisë (Zgjerimi i të mbjellave me zarzavate) në zonën Zejmen-Shënkoll - Fushë Kuqe me fokus ndërmjetësimin mes fermerëve të zonës dhe fabrikës përpunuese në Pllanë	M.5.1.1	200,000	PPP, Buxheti Shtetit, Donator/ IPARD			
5	Fuqizimi i sektorit të vitikulturës dhe enologjisë përmes mbështetjes së prodhimit vendas dhe markave rajonale (Arbri_Bukmirë/Rrëshen) dhe Kallmetit	M.5.1.1	100,000	PPP, Ministria e Bujqësisë, LERDA,			
6	Mbështetje e produkteve të ullirit dhe shegës në Balldren dhe Kallmet	M.5.1.1	100,000	PPP, Buxheti Shtetit, Donator/ IPARD			
7	Mbështetja e industrisë së përpunimit të peshkut përmes lehtësimit të ngritjes së flotave të peshkimit të përhershme dhe ndërmjetësimin mes tyre dhe pikave të përpunimit të peshkut	M.5.1.1	1,000,000	Fonde lokale, Qeveria, PPP, Donacione/IPARD			
8	Festivali Gastronomisë Ambulant për promovimin e markave vendase në Dajç, Shëngjin dhe Rrëshen si pjesë e festivalit të Zadrimës (Kallmeti, Arbri, Kosi Dudi, Fazanët e Fushë Kuqes, Gjeli Detit, Keci, Djathi etj)	M.5.1.2	60,000	PPP, NJQV, KQ, Donacione			
9	Informim, trajnim dhe asistencë për fermerët në lidhje me mundësitë për financim në kuadër të zhvillimit rural (identifikimin e target grupeve- ngritja e grupeve lokale të veprimit).	M.5.1.3	100,000	KQ, DRB, Donator			
10	Studimi i nevojave dhe identifikimi investimeve për ndërtimin e Dhomave Frigoriferike dhe Qendrave Magazinuese të produkteve bujqësore dhe blegtorale në rajonin e Lezhës me qendër në Zadrimë, Milot dhe Rrëshen	M.5.1.4	200,000	PPP, Buxheti Shtetit, Donator/ IPARD			
11	Koordinim me Bordin e Kullimit dhe Drejtorinë e Bujqësisë në realizimin e projekteve konkrete në drejtim të rehabilitimit të sistemit kullues dhe ujitës dhe eliminimin e përmytjeve. Mbështetje për hartimin e planit të veprimit në këtë drejtim	M.5.1.4	1,000,000	Qeveria Qendrore, Donator/ IPARD/ BB			
TURIZMI							
12	Mbështetje dhe koordinim për hartimin e Instrumenteve të Planifikimit të Territorit për NJQV-të Shëngjin, Shënkoll dhe Fushë Kuqe, me fokus zhvillimin e turizmit dhe mbrojtjen e natyrës	M.5.5.1	150,000	Fondet lokale, KQ, Qeveria, Donatorë			
13	Krijimi dhe promovimi i një produkti turistik duke përfshirë atraksionet turistike në komunat Fan, Orosh, Selitë dhe Kthellë dhe Njësitë Vendore që përfshijnë Parkun e Lurës (Shpellat karstike të Kthellës dhe Kroin e bardhë, Burgu i Spaçit, Parkun e Oroshit, Lurë, Kullat e Mirditës)	M.5.6.1	90,000	FZHR, LERDA, fonde lokale, PPP			
14	Krijimi dhe promovimi i një produkti turistik duke përfshirë atraksionet turistike në komunat Shëngjin, Shënkoll dhe Fushë Kuqe	M.5.6.1	100,000	EU Funds, IPARD			

15	Krijimi i një produkti turistik me fokus turizmin historik dhe fetar, duke përfshirë (Kisha e Laçit, Destinacionet në bashkinë e Lezhës, Kisha e Shën Eufemisë (Kallmet), Padre Antonio (Këmbanat e Paqes - Blinisht), etj, Pllanë, Rubik, Orosh)	M.5.6.1	80,000	LERDA, NJQV-te			
16	Promovimi i festivalit Zadrima në Fishtë	M.5.6.2	30,000	Fonde lokale, FZHR, grante si RDP, IPA CBC			
17	Krijimi i një platforme dixhitale për promovimin e destinacioneve turistike në Qarkun Lezhë (Strategjia e Turizmit e Qarkut Lezhë)	M.5.6.2	20,000	KQ, ZSHT, grante si RDP, IPA			
18	Restaurimi i Kishës Shën Barbara (Pllanë) dhe Shën e Premte (Balldre)	M.5.6.3	300,000	Fonde lokale, Qeveria, fonde IPA			
19	Ndërtimi rrjetit të infrastrukturës dhe sinjalistikës turistike në nënrajonin Orosh-Fan-Selitë (Kthellë-Selitë) që i shërbejnë eksplorimit të Shpellave Karstike dhe Kroin e Bardhë	M.5.6.4	500,000	Fonde lokale, Qeveria, FZHR, PPP, fonde IPA, etj			
20	Projektimi i një itinerari çiklistik përgjatë Drinit të vjetër, duke lidhur Zadrimën - Lezhë - Shëngjin (vazhdim i itinerarit të biçikletave/projekti i Dajçit B.B living the river)	M.5.6.4	100,000	Fonde lokale, Qeveria, PPP, donacione si RDP, IPA,			
21	Koordinim dhe mbështetje në hartimin e një Plani Transporti Publik Rajonal, me prioritet zonat turistike	M.5.6.4	30,000	Fonde lokale, KQ, Qeveria, MTI			
22	Identifikimi i shtigjeve, hartimi i hartave dhe i sinjalistikës përkatëse - <i>trekking tourism</i>	M.5.6.4	100,000	Fonde lokale, PPP, grante si RDP, IPA			
23	Hapja e një shkolle të mesme profesionale me fokus Hoteleri/Turizëm dhe kurseve profesionale në mbështetje të këtij sektori (Mbështetja e arsimit profesional në fushën e Hoteleri - Turizmit)	M.5.6.4	500,000	Fonde lokale, Qeveria, FZHR, PPP, fonde IPA, etj			
24	Trajnim i guidave turistike dhe stafit të sigurisë bregdetare në bashkëpunim me Shkollën e mesme profesionale të hoteleri/turizëm	M.5.6.4	100,000	Fonde lokale, PPP, grante si RDP, IPA			
	MJEDISI						
25	Sigurimi i integritetit territorial dhe biodiversitetit të sipërfaqeve pyjore dhe zgjerim i sipërfaqes së mbjellë - Orosh, Mirditë	M.5.4.2	200,000	Fonde lokale, Qeveria, PPP, donacione si IPARD			
26	Konsolidim i rrjetit KUZ në komunat Shënkoll & Zejmen (Ky projekt mund të zgjerohet dhe të përfshijë edhe komunat Shëngjin dhe Fushë Kuqe) dhe lidhja e këtij rrjeti me Impiante të Trajtimit të Ujërave të Zeza	M.5.4.2	1,000,000	Fonde lokale, Qeveria, PPP, donacione si IPARD			
27	Menaxhimi erozionit bregdetar një parakusht për mbrojtjen nga ndryshimet klimaterike (UNDP)	M.5.4.2		Buxheti Qendror, Donator			
28	Mbështetje njëjore vendore në zbatimin e Planit për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Hartuar me mbështetjen e SELEA në vitin 2013) dhe koordinim i zbatimit të tij	M.5.4.2	200,000	Buxheti Vendor, Qendror, Donator			
29	Identifikimi, Studimi Fizibilitetit dhe Plani Veprimi për parandalimin e erozionit në zonat e erodura të Qarkut Lezhë	M.5.4.2	250,000	Fonde lokale, Qeveria, PPP, EU Funds			
30	Përgatitja e studimit të fizibilitetit për të gjithë zonën e Deltës së lumit Drin - Mat në kuadrin e mbrojtjes nga ndryshimet klimatike (UNDP)	M.5.4.2	800,000	Buxheti Qendror, Donator			
31	Studim fizibiliteti dhe Promovimi i përdorimit të energjisë së rinovueshme (diellore) në njësitë e akomodimit (guesthouses) në Orosh, Fan, Selitë	M.5.4.3	150,000	Fonde lokale, Qeveria, PPP, donacione si IPARD			

INDUSTRIA							
32	Rehabilitimi zonave të dampave minerare në Orosh, Selitë, Rrëshen dhe Kaçinar	M.5.3.1	200,000	MEI, Ministria e Mjedisit			
33	Hartimi një strategjie për ruajtjen e ujërave nëntokësore nga ndotjet (infiltrimi ujit) në zonat e kontaminuara nga veprimtaritë industriale_Drejtoria e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar	M.5.3.1	150,000	MEI, MM, MBZHRAU, KQ			
34	Ndërtimi punishtes së riparimit të anijeve të flotës së peshkimit	M.5.3.1	250,000	MBZHRAU, MTI, Donator, Flota e Peshkimit			
35	Hartimi një Plani Veprimi për ndërhyrje në zonat kafe në rajon, promovimi dhe vendosja e tyre në funksion të stimulimit të investitorëve dhe donatorëve të huaj në bashkëpunim me Ministrinë	M.5.3.1	200,000	Investitorë të interesuar, Buxheti Shtetit, EU Funds			
36	Identifikimi, Studimi Fizibilitetit dhe Plani Veprimi për trajtimin e mbetjeve inerte nga aktiviteti industrial përgjatë lumenjve	M.5.3.1	150,000	Qeveria Qendrore, UNDP, EU funds			

III. Monitorimi

a. Metodologjia e monitorimit të zbatimit të Konceptit të Zhvillimit të Qarkut Lezhë

Procesi i monitorimit të zbatimit të Konceptit të Zhvillimit të Qarkut Lezhë mbështetet nga një grup indikatorësh të lidhur me treguesit sasiorë mbi numrin e aktiviteteve, numrin e përfituesve si dhe me një sërë treguesish të lidhur me impaktin dhe rezultatin. Përmes këtij procesi, indikatorët e monitorimit shprehin të dhëna mbi nivelin e realizimit të projekteve dhe aktiviteteve konkrete, duke lidhur këto të fundit me Masat në Konceptin Zhvillimit Rajonal duke ofruar një model monitorimi bazuar në indikatorët e monitorimit për çdo Masë. Kuadri logjik i këtij modeli monitorimi që mbështetet në zinxhirin: Fushë Prioritare => Qëllim Strategjik => Masë => Indikatorët e monitorimit => Njësia matëse, rezultojnë se indikatorët e monitorimit janë përcaktuar brenda fushës së veprimit të vetë Masës. Në identifikimin e indikatorëve të monitorimit janë konsideruar të gjithë projektet e parashikuara në Planin e Veprimit jo vetëm në aspektin sasior por edhe përmbajtësor. Për të ruajtur fokusin në Masat e Konceptit të Zhvillimit Rajonal të Qarkut Lezhë, pavarësisht shpërndarjes së projekteve në periudhën afatmesme 2015-2017 të parashikuar në Planin e Veprimit, janë vlerësuar 89 indikatorë monitorimi për 15 Masa të Konceptit të Zhvillimit Rajonal të Qarkut Lezhë, me një mesatare prej 6 indikatorësh për çdo Masë ose 15 indikatorësh për çdo Fushë Prioritare dhe Qëllim Strategjik. Ky grup indikatorësh synon përcjelljen dhe servirjen e informacionit të nevojshëm për vlerësimin e progresit në lidhje me Masën dhe njëherësh raportin mbi nivelin e realizimit të aktiviteteve dhe produkteve konkrete në periudhën 3 vjeçare (2015-2017) dhe ku viti 2014 konsiderohet si “viti bazë”. Sipas Fushave Prioritare, indikatorët e monitorimit janë si më poshtë:

Fusha Prioritare 1:

“Bujqësi, pylltari dhe peshkim” me fushë veprimi 4 Masa (mbështetje e bizneseve të vogla bujqësore, blegtorale dhe akuakultura; marka rajonale; edukimi në bujqësi, pylltari dhe peshkim; infrastruktura bujqësore) do të monitorohet nëpërmjet 25 indikatorëve të monitorimit në periudhën 2015-2017.

Fusha Prioritare 2:

“Edukim, kulturë, shëndetësi dhe përkujdesje sociale” me fushë veprimi 2 Masa (shërbimet sociale dhe shëndetësore në komunitetet lokale; shërbimet e edukimit dhe trajnimit profesional në qendrat më të rëndësishme të rajonit) do të mund të monitorohet nëpërmjet 20 indikatorëve të monitorimit në periudhën 2015-2017.

Fusha Prioritare 3:

“Zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura” me fushë veprimi 1 Masë (zonat e biznesit dhe infrastruktura përkatëse) do të mund të monitorohet nëpërmjet 6 indikatorëve të monitorimit në periudhën 2015-2017.

Fusha Prioritare 4:

“Mjedisi dhe energjia” me fushë veprimi 3 Masa (menaxhimi vizitorëve në zonat e mbrojtura; planifikimi dhe zbatimi infrastrukturës mjedisore; projekte energjetike për të ardhmen) do të mund të monitorohet nëpërmjet 14 indikatorëve të monitorimit në periudhën 2015-2017.

Fusha Prioritare 5:

“Menaxhimi rajonal, konteksti i partneriteteve brenda dhe ndër-rajonale & qeverisja e orientuar drejt qytetarit” me fushë veprimi 1 Masë do të mund të monitorohet nëpërmjet 7 indikatorëve të monitorimit në periudhën 2015-2017.

Fusha Prioritare 6:

“Sektori turizmit përmes promovimit të trashëgimisë kulturore, produkteve turistike dhe konsolidimit të shërbimeve turistike në rajon” me fushë veprimi 4 Masa do të mund të monitorohet nëpërmjet 17 indikatorëve të monitorimit në periudhën 2015-2017.

Në funksion të gjenerimit dhe vlerësimit të treguesve të lidhur me sektorë potencialë si bujqësia, blegtorja, demografia, arsimit, shëndetësia, kujdesi social, zhvillimi biznesit (aktiviteti ekonomik), shërbimet publike, infrastruktura, transporti, telekomunikacioni, qeverisja vendore dhe pjesëmarrja e gruas në vendimmarrje Këshilli i Qarkut Lezhë, do të mund të referojë të dhënat e servitura nga baza e të dhënave për Treguesit Socialë Ekonomikë të Qarkut. Kjo bazë të dhënash konsideron dhe përmbledh të gjithë informacionin statistikor të mbledhur nga vetë administrata e Qarkut Lezhë në institucione të ndryshme vendore, rajonale dhe kombëtare si dhe të dhëna të publikuara nga Instat (Census 2011). Në vlerësimin e këtij informacioni është e nevojshme pasurimi dhe rifreskimi këtij sistemi të dhënash për çdo vit, me qëllim leximin e raporteve të treguesve dhe vlerësimin e tyre në raport me prioritetet e vet Qarkut dhe impaktit të ndërhyrjeve në terren përmes projekteve konkrete. Kjo bazë të dhënash (file në excel) përfshin 12 fusha kryesore (sektorë) me 74 tregues kryesorë analitikë për 21 Njësi të Qeverisjes Vendore aktuale dhe konkretisht:

- Demografia përmes të dhënave statistikore mbi sipërfaqen, numrin e banesave, popullsinë në vitin 2001 dhe 2011 dhe indeksin e ndryshimit të popullsisë dhe treguesit gjinor (meshkuj/femra)
- Bujqësia dhe Blegtorja, përmes identifikimit të të dhënave në lidhje me fondin e tokës bujqësore, sipërfaqen e tokës sipas kategorive (truall, livadhe, pyje, kullota), toka inproduktive, tregues të lidhur me blegtorinë.
- Qeverisja dhe Financat Vendore përmes të dhënave mbi të zgjedhurit vendorë, përfaqësimin e grave në vendimmarrje, buxhetin vendor dhe shpërndarjen/banor, grantin e pakushtëzuar dhe shpërndarjen/banor.
- Punësimi ku identifikohen tregues statistikorë mbi papunësinë, numrin e të punësuarve në sektorin publik, numrin e të punësuarve në sektorin privat.
- Aktiviteti ekonomik i identifikuar përmes numrit të aktiviteteve ekonomike (tregtare); numrin e aktiviteteve sipas llojit (peshkim, industri, sektori ndërtimit dhe shërbimet) etj.
- Ndihma ekonomike dhe kujdesi social përmes treguesve mbi familjet në ndihmë ekonomike, numrin e personave në asistencë dhe numrin e personave me aftësi të kufizuara.
- Arsimit nëpërmjet identifikimit të të dhënave mbi numrin e nxënësve, numrin e nxënësve (popullsia) që ndjek arsimin e lartë, nivelin e analfabetizimit, numrin e mësuesve dhe raportin mësues/nxënës, institucionet e arsimit parashkollor, 9-vjeçar, të mesëm dhe profesional.
- Kujdesi Social përmes identifikimit të të dhënave mbi qendrat shëndetësore, ambulancat, poliklinikat, konsultoret për gra dhe fëmijë, spitalet dhe shtretërit, treguesit mbi personelin shëndetësor (numri mjekëve dhe infermierëve), vdekshmëria foshnjore (0-1 vjeç) në nivel Qarku.
- Shërbimet publike fokusuar në aksesin e familjeve/banesave në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe rrjetin e kanalizimeve, aksesin në shërbimin e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, aksesin në rrjetin telefonik dhe internet.

- Zhvillimi urban dhe infrastruktura të identifikuar përmes treguesve në lidhje me disponueshmërinë e instrumenteve të planifikimit hapësinor (Plan i Përgjithshëm Vendor i Planifikimit të Territorit), rrjeti rrugor në administrim, rrjeti rrugëve të brendshme, rrugëve lokale dhe komunale dhe numrin e aksidenteve rrugore.
- Telekomunikacioni përmes të cilit identifikohen të dhëna në lidhje me numrin e mjeteve të transportit, raporti / mijë banorë, aksesit në rrjetin hekurudhor.

Turizmi në aspektin e disponueshmërisë së potencialeve turistike dhe treguesve mbi numrin e vizitorëve (turistëve) përgjatë vitit.

Por si do të përdoren treguesit social – ekonomikë në funksion të prodhimit të informacionit për indikatorët e monitorimit?

Baza e të dhënave për treguesit social – ekonomikë sjell brenda një formati lehtësisht të përpunueshëm të dhëna sasiore mbi të gjithë sektorët kryesorë por, në të njëjtën kohë kjo bazë të dhënash, përmes metodës së kryqëzimit të të dhënave, ushqen me informacionin e nevojshëm indikatorët e monitorimit të Masave të parashikuara dhe konkretisht:

Fusha Prioritare “Zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura” ka si Qëllim Strategjik “Zhvillimi i sektorit privat përmes organizimit dhe bashkëpunimit të bizneseve, si dhe koordinimit të faktorëve të ndryshëm nxitës në nivel rajonal dhe kombëtar” dhe progresi i këtij Qëllimi Strategjik vlerësohet në raport me Masën “Përcaktimi i zonave të biznesit dhe infrastukturës përkatëse”. Në konformitet të plotë me fushën e veprimit të kësaj Mase, indikatorët e monitorimit janë të lidhur me rrjetin e rrugëve rurale të përmirësuara në Qark, numrin e banorëve që përfitojnë nga përmirësimi infrastrukturës rurale, numri aksidenteve rrugore si dhe të dhëna mbi numrin e njësisve vendore të pajisura me instrumentet ligjore të menaxhimit të territorit. Brenda setit të indikatorëve të kësaj Mase janë edhe treguesit të cilët vlerësojnë aksesin e popullsisë në shërbimin e furnizimit me ujë dhe rrjetin e kanalizimeve, informacioni i cili gjenerohet nëpërmjet databazës për treguesit social ekonomik të Qarkut Lezhë.

Fusha Prioritare “Mjedisi dhe energjia” ka si Qëllim Strategjik “Përmirësimi i infrastrukturës mjedisore dhe shërbimeve të lidhura me mjedisin si një parakusht për përmirësimin e mundësive social-ekonomike dhe si një faktor nxitës për koordinimin me sektorët e tjerë, si atë energjetik” vlerësohet në raport me progresin e 3 Masave, të cilat midis të tjerash prekin edhe infrastrukturën mjedisore dhe projektet energjetike. Indikatorët e monitorimit për këtë fushë veprimi përdorin tregues në lidhje me shpenzimet për menaxhimin e zonave të mbrojtura, me sipërfaqet e tokës bujqësore të dëmtuar nga erozioni, shpenzimet për zgjerimin e zonave të gjelbra (gjelbërimi), numrin e njësisve vendore të pajisura me instrumentet e menaxhimit të mbetjeve urbane (aksesi në shërbimin e pastrimit dhe largimit të mbeturinave) etj, tregues të cilët gjenerohen përmes informacionit të bazës së të dhënave për treguesit socialë ekonomikë të Qarkut Lezhë.

Në lidhje me shërbimet sociale dhe shëndetësore (Masa 5.2.1), indikatorët e monitorimit referojnë tregues statistikorë të lidhur me familjet në ndihmë ekonomike, numrin e personave me aftësi të kufizuar, përfituesit nga shërbimet sociale, nivelin e vdekshmërisë foshnjore, numrin e qendrave shëndetësore, ambulancave, numrin e personelit shëndetësor/mijë banor (mjekë dhe infermierë) etj.

Në lidhje me edukimin dhe trajnimin profesional (Masa 5.2.2), indikatorët e monitorimit referojnë të dhëna statistikore mbi numrin e nxënësve në sistemin arsimor 9 – vjeçar dhe të mesëm, numrin e nxënësve/klasë, raportin mësues/nxënës, tregues mbi frekuencën e arsimit profesional dhe nivelin e pjesëmarrjes së grave në kurset e trajnimit dhe formimit profesional etj, tregues të cilët identifikohen në rubrikën “Edukimi” të treguesve socialë ekonomikë të Qarkut Lezhë.

Brenda kuadrit logjik të ndërtimit të sistemit të monitorimit dhe plotësimit të informacionit përkatës për çdo indikator, përdorimi i bazës së të dhënave për treguesit socialë ekonomikë do të mund të rezultojë i drejtpërdrejtë ose përmes kombinimit të disa të dhënave në funksion të gjenerimit të informacionit dhe konkretisht:

Indikatorit nxënës në arsimin profesional/nxënësve në arsimin e mesëm gjenerohet nga raporti midis këtyre dy kategorive të treguesve në rubrikë "Edukimi". Një tjetër alternativë e përdorimit të bazës së të dhënave për treguesit socialë ekonomikë përmes metodës së kombinimit do të referohej në rastin e indikatorit "personel shëndetësor/mijë banorë" tregues i cili konsideron numrin e popullsisë (rubrika "Demografia") dhe numrin e personelit shëndetësor (rubrika "Shëndetësia). Në leximin e të dhënave nga indikatorët e monitorimit dhe krahasimit të treguesve në kohë, viti 2014 është konsideruar si viti bazë, treguesit në të cilin shërbejnë për vendosjen e sistemit të krahasimit për periudhën e parashikuar 2015-2017. Formatit Matricës së Monitorimit për çdo Masë identifikon: (a) Masën dhe Qëllimin Strategjik; (b) Indikatorët e Monitorimit; (c) Njësinë matëse të indikatorit të monitorimit; (d) Treguesit e Monitorimit 2014-2017 dhe (e) Përgjegjësia institucionale e cila identifikon drejtorinë/departamentin përgjegjës për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit.

b. Indikatorët e monitorimit për çdo masë

Referuar Masave të Konceptit të Zhvillimit Rajonal të Qarkut Lezhë, procesi monitorimit do të mundësohet nëpërmjet indikatorëve të monitorimit për çdo Masë dhe plotësimin të informacionit për periudhën e referuar në Matricën e Monitorimit 2014-2017 ku të dhënat për vitin 2014 do të gjenerohen në Janar 2015.

Qëllimi Strategjik:

"Zhvillimi i mëtejshëm i bujqësisë dhe agrobiznesit të lidhur në një rrjet me kapacitete të larta industriale"

Për këtë Qëllim Strategjik janë identifikuar 4 Masa të cilat kanë për fushë veprimi (1) Mbështetje e koordinuar për bizneset e vogla bujqësore, blegtorale dhe akuakulturën; (2) Marka Rajonale; (3) Edukimi në bujqësi, pylltari dhe peshkim dhe (4) Infrastruktura bujqësore. Indikatorët e monitorimit sipas Masave janë si më poshtë:

Qëllimi Strategjik: "Zhvillimi i mëtejshëm i bujqësisë dhe agrobiznesit të lidhur në një rrjet me kapacitete të larta industriale"							
MASA	Indikatorët e Monitorimit të Masës	Njësia Matëse	Treguesit e Monitorimit 2014-2017				Përgjegjësia Institucionale
			Viti Bazë (2014)	2015	2016	2017	
5.1.1. Mbështetje e koordinuar për bizneset e vogla bujqësore, blegtorale dhe akuakulturën	Numri i prodhuesve të vegjël të mbështetur për marketimin e produkteve bujqësore brenda vendit	Numër					1-Drejtoria e Programim Zhvillimit e Investimeve. 2-Drejtoria Rajonale e Bujqësisë
	Numri personave/fermerëve që përfitojnë nga skemat e financimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe programet e BE-së në fushën e bujqësisë, industrisë agro-ushqimore, bletarisë dhe blegtorisë	Numër (dhe/ose %-je ndaj totalit)					
	Zgjerimi sipërfaqes së tokës bujqësore me destinacion kultivimin e produkteve tipike në rajon (gështenjë, arrë etj)	Ha					
	Zgjerimi aktivitetit ekonomik në bujqësi dhe peshkim	% e raportit të bizneseve në fushën e bujqësisë e peshkimit/ nr të bizneseve në Qark					
	Sipërfaqe e tokës bujqësore e destinuar për vreshtari, pemëtari dhe perime	Ha					
	Numri krerëve të bagëtisë së të imët në rajon	Numër					
	Numri shpendëve në rajon (gjeli detit, fazan)	Numër					
	Sip. e tokës bujqësore e destinuar për kultivimin e bimëve medicinale (ha ndaj totalit të tokës bujqësore)	Ha					
Numri të punësuarve/vetëpunësuarve në sektorin bujqësor, blegtoral dhe agro-ushqimor	Numër					1-Drejtoria e Programim Zhvillimit e Investimeve. 2-Drejtoria Rajonale e Punës	
%-je e papunësisë në Qark	%-je					1-Drejtoria e Programim Zhvillimit e Investimeve. 2-QKL	

Monitorimi Masës 5.1.1 është i lidhur me 10 indikatorë monitorimi, të cilët identifikojnë informacionin në lidhje me fushën e veprimit të vetë Masës, përmes të dhënave sasiore mbi numrin e prodhuesve të mbështetur në marketimin e produkteve bujqësore, nivelin e përfitimit nga programet e Qeverisë Qendrore për mbështetjen e fermerëve, aktiviteti ekonomik dhe sektorin e blegtorisë. Një tjetër aspekt i monitorimit të masës vlerësohet edhe prodhimi informacionit mbi impaktin e realizimit të projekteve dhe aktiviteteve të lidhura me këtë Masë sikurse janë treguesit për kultivimin e tokës bujqësore dhe impakti në rritjen e numrit të të punësuarve dhe vetëpunësuarve në sektorin përkatës. Ky indikator “ushqen” me informacion edhe bazën e të dhënave për treguesit social – ekonomikë të Qarkut Lezhë duke siguruar raporte të dhënash të lidhura me sektorin e bujqësisë, blegtorisë, peshkimit, biznesin dhe me nivelin e papunësisë.

Qëllimi Strategjik: “Zhvillimi i mëtejshëm i bujqësisë dhe agrobiznesit të lidhur në një rrjet me kapacitete të larta industriale”							
MASA	Indikatorët e Monitorimit të Masës	Njësia Matëse	Treguesit e Monitorimit 2014-2017				Përgjegjësia Institucionale
			Viti Bazë (2014)	2015	2016	2017	
5.1.2. Marka rajonale	Numri i markave të promovuara (Shoqatat e Prodhuesve sipas Markave)	Numri markave					1-Drejtorja e Zhvillimit Rajonal dhe Integritimit. 2-Njësitë Vendore
	Numri panairëve agro-bujqësore të organizuara në bashkëpunim me prodhuesit sipas markave dhe gastronomisë	Numri panairëve					
	Numri kontratave të lidhura me subjektet e tregtimit të produkteve (lokal, kombëtar, rajonal) për markat rajonale	Numri kontratave					
	Numri njësive prodhuese pjesëmarrëse në aktivitetet dhe panairët promovues të markave respektive	Numër					1-Drejtorja e Zhvillimit Rajonal dhe Integritimit. 2- Qendra e Kurseve të Kualifikimi Profesional

Monitorimi Masës 5.1.2 është i lidhur me 4 indikatorë të monitorimit të cilët mbulojnë fushën e veprimit të Masës duke identifikuar jo vetëm aktivitetet në funksion të promovimit të markave por edhe rezultateve konkrete të aktiviteteve respektive në funksion të rritjes së kapaciteteve ekonomike të prodhuesve.

Qëllimi Strategjik: “Zhvillimi i mëtejshëm i bujqësisë dhe agrobiznesit të lidhur në një rrjet me kapacitete të larta industriale”							
MASA	Indikatorët e Monitorimit të Masës	Njësia Matëse	Treguesit e Monitorimit 2014-2017				Përgjegjësia Institucionale
			Viti Bazë (2014)	2015	2016	2017	
5.1.3. Edukimi në bujqësi, pylltari dhe peshkim	Numri i peshkatarëve, specialistëve dhe kapitenëve që ndjekin kursin e kualifikimit 9-mujor në Durrës	Numër					1-Drejtorja e Programim Zhvillimit e Investimeve. 2-Drejtorja Rajonale e Punës
	Numri i të punësuarve në sektorin e peshkimit dhe akuakulturës	Numër					1-Drejtorja e Programim Zhvillimit e Investimeve. 2-Drejtorja Rajonale e Bujqësisë Lezhë
	Indeksi i rritjes së prodhimit të peshkut çdo vit	Tregues në %-je ose ton					
	Numri i aktiviteteve, workshop-eve, trajnimeve të organizuara me fermerët në sektorin e bujqësisë, vreshtarisë, enologjisë	Numër					1-Drejtorja e programim zhvillimit e investimeve. 2-Drejtorja Rajonale e Shërbimit Pyjor
	Numri i trajnimeve profesionale dhe aktiviteteve informuese për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave (mbrojtjen e mjedisit)	Numër					1-Drejtorja e Programim Zhvillimit e Investimeve. 2-Drejtorja Rajonale e Bujqësisë
	Rritja e sipërfaqes pyjore, kullotave dhe livadheve në Qark	Ha					1-Drejtorja e Programim Zhvillimit e Investimeve 2-Drejtorja Rajonale e Bujqësisë 3-Bordi i Kullimit

Për këtë Masë janë identifikuar 6 indikatorë monitorimi të cilët identifikojnë nivelin e kualifikimit profesional të flotës së peshkimit, rritjen dhe zgjerimin e aktivitetit të peshkimit por edhe tregues të lidhur me sektorin e bujqësisë, vreshtarisë dhe enologjisë në rajon. Të tjerë tregues të rëndësishëm të përcjellë përmes indikatorëve të monitorimit janë edhe raportet që identifikohen në sektorin e pylltarisë dhe kullotave e livadheve duke sjellë së bashku aktorë të ndryshëm në nivel rajonal (Këshilli Qarkut, Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Pyjor dhe Bordin e Kullimit). Ky indikator shkon edhe në funksion të përmirësimit dhe përditësimit të bazës së të dhënave për treguesit social – ekonomikë të Qarkut Lezhë.

Qëllimi Strategjik: “Zhvillimi i mëtejshëm i bujqësisë dhe agrobiznesit të lidhur në një rrjet me kapacitete të larta industriale”							
MASA	Indikatorët e Monitorimit të Masës	Njësia Matëse	Treguesit e Monitorimit 2014-2017				Përgjegjësia Institucionale
			Viti Bazë (2014)	2015	2016	2017	
5.1.4. Infrastruktura Bujqësore	Sipërfaqe e tokës bujqësore e pajisur me sistem kanalesh ujitëse	Ha					1-Drejtoria e Programim Zhvillimit e Investimeve. 2-Drejtoria Rajonale e Bujqësisë. 3-Bordi i Kullimit Lezhë
	Mi gjatësi kanalesh ujitëse dhe kulluese të rehabilituar dhe sistemuar	Metër linear (ml)					
	Reduktimi i sipërfaqeve të tokës bujqësore të lënë djerrë (të përmbytur - inproduktive)	Ha					
	Shpenzimet kapitale për rehabilitimin e infrastrukturës bujqësore	Niveli shpenzimeve kapitale/banor					1-Drejtoria e Programim Zhvillimit e Investimeve 2-Drejtoria Rajonale e Bujqësisë Lezhë.
	Numri qendrave grumbulluese dhe magazinuese në rajon për prodhimin bujqësor	Numër					1-Drejtoria e Programim Zhvillimit e Investimeve 2-Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Lezhë.

Fusha e veprimit të Masës 5.1.4 është parashikuar të monitorohet përmes 5 indikatorëve të monitorimit të cilët do të duhet të konsiderohen jo vetëm për formatin e informacionit por edhe për ndërthurjen e llojit të informacionit që përcjellin. Indikatorët e monitorimit të përdorur në këtë Masë vlerësojnë informacionin i cili gjenerohet përmes bazës së të dhënave të treguesve social – ekonomikë të Qarkut, por njëkohësisht identifikojnë nivelin e ndërhyrjeve (shpenzimet kapitale/banor) dhe rezultatin e ndërhyrjeve në përmirësimin e infrastrukturës bujqësore.

Qëllimi Strategjik:

“Shërbime publike cilësore në fushën e arsimit, kulturës dhe kujdesit social, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme nga publiku, prezente në të gjithë territorin e Qarkut, dhe veçanërisht për grupet e ndryshme sociale”

Për këtë Qëllim Strategjik janë identifikuar 2 Masa të cilat kanë për fushë veprimi (1) Zhvillimin e shërbimeve sociale e shëndetësore në komunitetet lokale dhe (2) Zhvillimin e shërbimeve të edukimit dhe trajnimit profesional në qendrat më të rëndësishme të rajonit. Indikatorët e monitorimit sipas Masave janë:

Qëllimi Strategjik: "Shërbime publike cilësore në fushën e arsimit, kulturës dhe kujdesit social, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme nga publiku, prezente në të gjithë territorin e Qarkut, dhe veçanërisht për grupet e ndryshme sociale"

MASA	Indikatorët e Monitorimit të Masës	Njësia Matëse	Treguesit e Monitorimit 2014-2017				Përgjegjësia Institucionale
			Viti Bazë (2014)	2015	2016	2017	
5.2.1. Zhvillimi i shërbimeve sociale dhe shëndetësore në komunitetet lokale	Numri i përfituesve në Qendrat e Moshës së tretë që përfitojnë shërbime sociale	Numër					1-Drejtoria e Programim Zhvillimit e Investimeve. 2-Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Lezhë.
	Numri i familjeve në nevojë që përfitojnë shërbime sociale	Numër					
	Numri i personave me aftësi të kufizuara që përfitojnë nga shërbimet sociale dhe qendrat komunitare	Numër					1-Drejtoria e Programim Zhvillimit e Investimeve. 2-Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik Lezhë.
	Numri i qendrave shëndetësore, ambulancave të ndërtuara ose rikonstruara	Numër					1-Drejtoria e Programim Zhvillimit e Investimeve. 2-Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social
	Numri i romëve që përfiton shërbime sociale	Numër					1-Drejtoria e Programim Zhvillimit e Investimeve. 2-Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik Lezhë
	Numri i mjekëve / 1000 banorë	Tregues i numrit të mjekëve / banor në rang Qarku					
	Numri i infermierëve / 1000 banorë	Tregues i numrit të infermierëve/banor Qark	4.8				
	Raporti i shtretërve / 1000 banorë	Numër shtretër/1000 banorë në rang Qarku					
	Niveli i vdekshmërisë foshnjore 0-1 vjeç	Numër	7.1				
Numri i personelit shëndetësor në zonat rurale të Qarkut	Numër					1-Drejtoria e Programim Zhvillimit e Investimeve. 2-DRSHP, 3. Instat	

Monitorimi Masës 5.2.1 është i lidhur me gjenerimin e të dhënave për 10 indikatorëve të monitorimit, të dhëna të cilat do të koordinohen me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Lezhë (për indikatorët me fokus Kujdesin Social dhe me referencë rubrikën "Kujdesi Social dhe Ndhma Ekonomike në bazën e të dhënave) dhe Drejtorinë e Shëndetit Publik për referimin e indikatorëve të lidhur me shërbimin shëndetësor (statistika mbi nivelin e ofrimit të shërbimit shëndetësor, vdekshmërinë foshnjore etj). Në plotësimin e të dhënave për këta indikatorë, do të duhet të vlerësohen dhe kombinohen raportet e popullsisë (demografia) dhe numrit të personelit shëndetësor (mjekë dhe infermierë) të cilët janë pjesë e rubrikës "Shëndetësia" në bazën e të dhënave për treguesit socialë ekonomikë të Qarkut.

Qëllimi Strategjik: "Shërbime publike cilësore në fushën e arsimit, kulturës dhe kujdesit social, të cilat janë lehtësisht të aksesueshme nga publiku, prezente në të gjithë territorin e Qarkut, dhe veçanërisht për grupet e ndryshme sociale"

MASA	Indikatorët e Monitorimit të Masës	Njësia Matëse	Treguesit e Monitorimit 2014-2017				Përgjegjësia Institucionale
			Viti Bazë (2014)	2015	2016	2017	
5.2.2. Zhvillimi i shërbimeve të edukimit dhe të trajnimit profesional në qendrat më të rëndësishme të rajonit	Numri i nxënësve që përfitojnë kushte bashkëkohore në sistemin arsimor nga përmirësimi i infrastrukturës arsimore	Numër					1-Drejtoria e Programim Zhvillimit e Investimeve. 2-Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik Lezhë. 3-Instat
	Numri i nxënësve/klasë në sistemin arsimor 9-vjeçar	Numër					
	Shpenzimet e njësive vendore për mirëmbajtjen e objekteve arsimore (%-je e buxhetit vendor për objektet arsimore)	Shpenzimet e mirëmbajtjes nga NjQV-të/nr. e nxënësve					
	Niveli i investimeve kapitale/nxënës	Shpenzimet kapitale/nxënës					
	Raporti mësues : nxënës në sistemin arsimor	Tregues					
	Numri i paketave të kurseve profesionale të ofruara (mekanik, menaxhim tregtie & turizmi, elektrikist, gjuhë angleze dhe artizanat) brenda vitit 2017 (target 5)	Numër					
	%-je e nxënësve në arsimin profesional në raport me totalin e nxënësve në arsimin e mesëm	%-je					
	%-je e personave në ndihmë ekonomike të përfshirë në arsimin dhe programet e trajnimit profesional	%-je					
	Niveli analfabetizimit në Rajon	%-je	3.54				
	%-je e grave/femrave të përfshira në arsimin profesional	%-je					

Brenda fushës së veprimit të kësaj Mase vijnë së bashku tregues të lidhur me sistemin arsimor (9-vjeçar dhe të mesëm), por duke fokusuar edhe tregues të lidhur me arsimin profesional. Së bashku me treguesit për arsimin, identifikohen edhe tregues të lidhur me nivelin e përfitimit nga familjet në nevojë dhe kualifikimin e grave në fusha si turizëm, artizanat etj. Monitorimi Masës përmes 10 indikatorëve të monitorimit siguron informacion në lidhje me tregues të cilët reflektohen edhe në bazën e të dhënave për treguesit social – ekonomikë të Qarkut Lezhë, si dhe ndërtojnë raporte krahasueshmërie jo vetëm në nivel rajonal por edhe kombëtar (niveli analfabetizmit në rajon).

Qëllimi Strategjik:

“Zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura”

Për këtë Qëllim Strategjik është identifikuar 1 Masë e cila ka si fushë veprimi përcaktimin e zonave të biznesit dhe infrastrukturës përkatëse. Indikatorët e monitorimit për këtë Masë janë si më poshtë:

Qëllimi Strategjik: “Zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura”							
MASA	Indikatorët e Monitorimit të Masës	Njësia Matëse	Treguesit e Monitorimit 2014-2017				Përgjegjësia Institucionale
			Viti Bazë (2014)	2015	2016	2017	
5.3.1. Përcaktimi i zonave të biznesit dhe infrastrukturës përkatëse	Km të rrugëve rurale të përmirësuara në nivel Qarku	Km					1-Drejtoria e Programim Zhvillimit e Investimeve. 2- Instat
	Numri i banorëve që përfitojnë nga përmirësimi infrastrukturës rurale	Numër					Drejtoria e Programim 2-Drejtoria e Planifikimit Territorial (K.Q.Lezhë). 3-Urbanistika e NjQV-ve
	Numri i aksidenteve rrugore	Numër					Drejtoria e Programim Zhvillimit e Investimeve 2-Njësitë Vendore 3-INSTAT/Policia
	Numri i njësive vendore të pajisura me Planin e Përgjithshëm Vendor të Planifikimit të Territorit	Numër					Drejtoria e Programimit 2-Drejtoria e Planifikimit Territorial (K.Q.Lezhë). 3-Urbanistika e NjQV-ve
	Shpenzimet kapitale (në nivel rajonal për të gjithë NjQV-të) për infrastrukturën (rrjeti rrugor)	%-je e raportit shpenzimeve kapitale për infrastrukturën/ buxhetit vendor					Drejtoria e Programim Dega Thesarit, Prefektura
	Popullsia që ka akses në shërbimin e furnizimit me ujë (target 70% në vitin 2017 nga 40% aktualisht)	%-je	40%				1. Drejtoria e Programim Zhvillimit e Investimeve. 2 .Sh.A. Ujësjellës-Kanalizime. 3. Instat

Për këtë Masë janë identifikuar 6 indikatorë të monitorimit të cilët identifikojnë të dhëna në lidhje me rrjetin rrugor të përmirësuar dhe të mirëmbajtur (për më shumë shih treguesit socialë ekonomikë të Qarkut rubrika “Zhvillimi Urban, infrastruktura dhe siguria rrugore”) si dhe numrin e aksidenteve rrugore në Qark. Një tjetër tregues i lidhur me fushën e veprimit të kësaj Mase është edhe treguesi për aksesin e popullsisë në shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe rrjetin e kanalizimeve, tregues i cili do të duhet të reflektohet edhe në bazën e të dhënave për treguesit socialë ekonomikë të Qarkut Lezhë.

Qëllimi Strategjik:

“Përmirësimi i infrastrukturës mjedisore dhe shërbimeve të lidhura me mjedisin si një parakusht për përmirësimin e mundësive social-ekonomike dhe si një faktor nxitës për koordinimin me sektorët e tjerë, si atë energjetik”

